FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 72

Tiranë – E hënë, 21 maj 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 16, datë 7.5.2018	Për organizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë.....	4563
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 17, datë 9.5.2018	Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë.....	4564
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 7.5.2018	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 2030, datë 16.3.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 679, datë 30.3.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-534, datë 27.4.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	4566
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 24, datë 11.5.2018	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	4570
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 98, datë 30.4.2018	Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve, që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.....	4572
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 99, datë 30.4.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të Rrjetit për kërkesat e lidhjes me rrjetin e sistemeve me tension të lartë me rrymë të vazhduar dhe parqet me module të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar (HVDC).....	4577

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 100, datë 30.4.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve.....	4577
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 101, datë 30.4.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të Rrjetit për ngarkesën.....	4578
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 102, datë 30.4.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018", midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.....	4579
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 103, datë 30.4.2018	Mbi miratimin e programit të pajtueshmërisë së OST sh.a.....	4580
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 104, datë 30.4.2018	Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit"	4597
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 105, datë 30.4.2018	Mbi licencimin e shoqërisë "Malësia Solar 1" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw.....	4599
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 106, datë 30.4.2018	Mbi licencimin e shoqërisë "Malësia Solar 2" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw.....	4600
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 107, datë 30.4.2018	Mbi licencimin e shoqërisë "Malësia Solar 3" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw.....	4601
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 7448/5, datë 10.5.2018	Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerim i hapësirës së varrezave në fshatin Shenepremte", Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë.....	4602
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 7226, datë 9.5.2018	Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i rrjetit rrugor, Bashkia Shijak", loti 1.....	4602
	Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të zhdukur të shtetasit Jovan Doce.....	4603
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilir Gosa.....	4603
	Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 19, datë 19.1.2018, të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, "Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike, për vitin 2018", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 10, datë 31 janar 2018.....	4603

UDHËZIM
Nr. 16, datë 7.5.2018

PËR ORGANIZIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2018, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, pika 2, shkronja "a" dhe 51, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, të jenë:

a) Gjuhë e huaj (D3) 27 gusht 2018;
b) Gjuhë shqipe dhe letërsi (D1) 30 gusht 2018;
c) Matematikë (D2) 3 shtator 2018;
d) Provime me zgjedhje (Z1/Z2) 7 shtator 2018.

2. Provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, të fillojnë në orën 10:00.

a) Provimet e lëndëve me detyrim të zgjasin 2 orë e 30 minuta.

b) Provimet e lëndëve me zgjedhje të zgjasin 3 orë.

3. Administrimi dhe procedurat për shpërndarjen dhe grumbullimin e materialeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2018, sesioni dytë, bazohen në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2018, miratuar me urdhrin nr. 672, datë 29.12.2017, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

4. Testi për secilin nga provimet e detyruara të përmbajë 25 pyetje, nga të cilat 13 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 13 pikë, ndërsa 12 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të vlerësohen me 37 pikë.

5. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje të përmbajë 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 10 pikë, ndërsa 10 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të vlerësohen me 30 pikë.

6. Maturantët që kanë vetëm një provim me zgjedhje, të hyjnë në provim në orën 11:00 dhe ta përfundojnë atë në orën 13:00.

7. Në provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:

a) Maturantët/kandidatët që rezultuan mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2018, sesioni i parë.

b) Maturantët që rezultuan mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2017–2018 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 22 gusht 2018.

c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2017, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore.

d) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit dhe kanë të njësuar dokumentet shkollore nga MASR-ja.

8. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 7, germa "a" dhe "b", të plotësojnë formularin A1Z për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore.

9. Kandidatët/kandidatët e përcaktuar në pikën 7, germa "c" dhe "d", të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton DAR/ZA-ja e vendbanimit të tyre. Këta kandidatë të plotësojnë formularin A1Z në datat 21–23 gusht 2018.

10. Drejtori i shkollës të dërgojë zyrtarisht në DAR/ZA listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, deri më 23 gusht 2018. Drejtori i DAR/ZA-së ta dërgojë këtë listë në QSHA në datën 24 gusht 2018.

11. Provimet të zhvillohen të përqendruara në drejtoritë arsimore rajonale. ZA Tropojë, ZA Lushnjë dhe ZA Sarandë t'i zhvillojnë provimet në qytetet e tyre. ZA Delvinë t'i zhvillojë provimet në qytetin e Sarandës.

12. Drejtoritë arsimore rajonale dhe drejtoritë e shkollave të marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, mjedisin dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë.

13. Drejtori i DAR/ZA-së, brenda datës 20 gusht 2018, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në për mjedisin ku do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë.

14. Në DAR ku numri i maturantëve/i kandidatëve është më i madh se 500, të përdoren 2 mjedise.

15. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MASR-së dhe të institucioneve të varësisë.

16. Shpenzimet e përfaqësuesve të MASR-së, në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2018, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, sipas dispozitave në fuqi.

17. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Financave, Qendra Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Instituti Zhvillimit të Arsimit, njësitë arsimore vendore dhe shkollat.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 17, datë 9.5.2018

PËR PROCEDURAT E NDJEKJES SË ARSIMIT TË DETYRUAR NGA NXËNËSIT QË NUK KANË NDJEKUR TË PAKTËN DY KLASA TË ARSIMIT BAZË DHE PËR ARSIMIMIN ME KOHË TË PJESSHME NË ARSIMIN BAZË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikave 4 e 5 të nenit 22, të shkronjës "b", të nenit 16 dhe shkronjave "a" dhe "dh", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. ARSIMIMI I NXËNËSVE QË NUK KANË NDJEKUR TË PAKTËN DY KLASA TË ARSIMIT BAZË ME KOHË TË PLOTË

KREU 1
RIKTHIMI I NXËNËSIT NË ARSIMIN BAZË ME KOHË TË PLOTË

1. Gëzon të drejtën për të ndjekur arsimin bazë me kohë të plotë, brenda moshës së arsimit të detyruar, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim, fëmija që, për arsye të ndryshme:

a) Ka mbushur të paktën moshën tetë vjeç dhe nuk është regjistruar në klasën e parë ose e ka ndërprerë atë;

b) Nuk ka përfunduar një klasë të arsimit bazë dhe nuk është regjistruar në atë klasë në vitin pasues;

c) Ka përfunduar një klasë të arsimit bazë dhe nuk ka frekuentuar, në të paktën, dy vitet shkollore pasuese;

d) Është mbetës në një klasë dhe nuk e ka përsëritur atë klasë për të paktën dy vite shkollore pasuese;

e) Identifikohet i paregjistruar në shkollë;

f) Është i regjistruar në shkollë, por identifikohet si fëmijë në situatë rruge;

g) Është i regjistruar në shkollë, por e ka braktisur atë.

2. Rikthimi i nxënësit në shkollë bëhet në çdo periudhë të vitit shkollor.

KREU 2
PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

1. Prindi që ka fëmijën në një nga rrethanat e parashikuara në pikën 1, të kreut 1, i drejton kërkesën njësisë arsimore vendore (NJAV) përkatëse për regjistrimin/rikthimin e fëmijës në shkollë.

2. Kërkesa për regjistrimin e fëmijës në shkollë mund të bëhet dhe nga vetë NJAV-ja, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, nga njësitë për mbrojtjen e fëmijës dhe nga çdo institucion shtetëror apo OJF që e identifikon një fëmijë në një nga rrethanat e parashikuara në pikën 1, të kreut 1.

3. NJAV-ja cakton shkollën e arsimit bazë ku fëmija do të regjistrohet.

4. Fëmija regjistrohet në shkollë sipas procedurave të regjistrimit të zakonshëm të parashikuara në aktin përkatës të nxjerrë nga ministri përgjegjës për arsimin.

5. Fëmija regjistrohet në klasën me grup-moshë të njëjtë me moshën e tij ose një vit më pak se kjo grup-moshë.

KREU 3
PROCESI MËSIMOR DHE VLERËSIMI

1. Drejtoria e shkollës, në bashkëpunim me mësuesin kujdestar të fëmijës, organizon hartimin nga mësuesit përkatës të programeve mësimore individuale.

2. Në programin mësimor individual, në përgjithësi, mësuesi lëndor vendos nivelin bazë të rezultateve të të nxënit sipas kompetencave kyç të programit të shkallës së cilës i përket klasa që nxënësi nuk e ka ndjekur ose nuk e ka përfunduar.

3. Mësuesi ose mësuesit punojnë në mënyrë të diferencuar me nxënësin brenda dhe jashtë klasës.

4. Drejtoria e shkollës, në bashkëpunim me mësuesin kujdestar, përpiqet t'i sigurojë nxënësit ndihmë plotësuese nëpërmjet:

a) "Mësuesve vullnetarë", që janë prindër, mësues pensionistë ose persona të tjerë nga komuniteti;

b) Bashkëpunimit me qeverinë e nxënësve;

c) Mësuesve ndihmës.

5. Nxënësi vlerësohet sipas procedurave të vlerësimit të nxënësve të klasës që ndjek.

6. Vlerësimet shënohen në regjistrin e klasës përkatëse.

7. Nxënësi kalon klasën, i nënshtrohet provimit të sesionit të dytë ose përsërit klasën, sipas rregullave të klasës që ndjek.

II. ARSIMIMI I TË RRITURVE QË NUK KANË ARRITUR TË MBAROJNË ARSIMIN BAZË ME KOHË TË PLOTË

KREU 4
PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

1. Nxënësit që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë, kanë të drejtë të regjistrohen në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme.

2. NJAV-ja cakton shkollën/shkollat e arsimit bazë ku do të ofrohet arsimi bazë me kohë të pjesshme.

3. Dokumentet që duhen për regjistrim, janë:

a) Kërkesë për regjistrim në shkollën ku ofrohet arsimi bazë me kohë të pjesshme.

b) Dëftesë ose vërtetim me nota për klasën e fundit të kryer.

4. I rrituri që pretendon se ka formim shkollor për të vijuar arsimin bazë me kohë të pjesshme në një apo dy klasa më të larta se klasa për të cilën zotëron dokument shkollor, provohet nga një komision i përbërë nga mësues të fushave të ndryshme të të nxënit, i kryesuar nga drejtori i shkollës. Komisioni vendos se në cilën klasë do të regjistrohet i interesuari për të vijuar arsimin bazë me kohë të pjesshme.

5. I rrituri që nuk zotëron dokument shkollor për klasën e fundit të kryer, provohet nga një komision i përbërë nga mësues të fushave të ndryshme të të nxënit, i kryesuar nga drejtori i shkollës. Komisioni vendos se në cilën klasë do të regjistrohet i interesuari për të vijuar arsimin bazë me kohë të pjesshme.

KREU 5
KOHËZGJATJA DHE KURRIKULA

1. Arsimi bazë me kohë të pjesshme zgjat nëntë vite shkollore (klasat I–IX).

2. Arsimi bazë me kohë të pjesshme funksionon me tri ditë mësim në javë (me klasa të veçanta ose të bashkuara, kur numri i nxënësve është më i vogël se numri i nxënësve për klasë).

3. Plani mësimor dhe programet lëndore të arsimit bazë me kohë të pjesshme hartohen nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe miratohen nga ministri.

4. Struktura e vitit shkollor për arsimin bazë me kohë të pjesshme njoftohet në udhëzimin e vitit shkollor.

KREU 6
FREKUENTIMI, VLERËSIMI DHE KALIMI I KLASËS

1. Drejtoria e shkollës dhe NJAV-ja monitorojnë klasat e arsimit bazë me kohë të pjesshme për të dhënë ndihmesën në përmirësimin e vazhdueshëm të punës në to.

2. Shkolla u vë në dispozicion klasave të arsimit bazë me kohë të pjesshme mjetet mësimore, laboratorët dhe kabinetet e TIK-ut, si dhe i përfshin nxënësit e këtyre klasave në veprimtari jashtëshkollore.

3 .Ekipi kurrikular i shkollës trajton posaçërisht aspekte të zhvillimit profesional të mësuesve që punojnë me nxënësit e arsimit bazë me kohë të pjesshme.

4. Të drejtat dhe detyrat e nxënësit të arsimit bazë me kohë të pjesshme janë të njëjta me ato të nxënësit të arsimit bazë me kohë të plotë.

5. Psikologu dhe punonjësi social në shkollë u kushtojnë vëmendje të posaçme edhe nxënësve të arsimit bazë me kohë të pjesshme.

6. Nxënësi i arsimit bazë me kohë të pjesshme vlerësohet sipas procedurave të vlerësimit të nxënësve në arsimin bazë me kohë të plotë.

7. Në përfundim të çdo klase, nxënësi i arsimit bazë me kohë të pjesshme pajiset me dëftesë klase.

8. Nxënësi kalues i klasës së nëntë pajiset me dëftesën e arsimit bazë pasi të jetë kalues në provimet kombëtare të arsimit bazë.

9. NJAV-të dhe shkollat bashkëpunojnë me OJF-të dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore për t'u siguruar nxënësve të arsimit bazë me kohë të pjesshme lehtësira për ndjekjen rregullisht të mësimeve.

KREU 7
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimet e MASH-it nr. 29, datë 2.8.2013, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme", dhe nr. 31, datë 2.8.2013, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë", shfuqizohen.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, njësitë arsimore vendore dhe shkollat e arsimit bazë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

VENDIM
Nr. 15, datë 7.5.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Vitore Tusha	anëtare e	" "
Fatmir Hoxha	anëtar i	" "
Gani Dizdari	anëtar i	" "
Fatos Lulo	anëtar i	" "
Besnik Imeraj	anëtar i	" "

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.12.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 64/7 akti, që u përket:

KËRKUES: Spartak Gjikdhima, Elion Shkurtaj, shoqëria "Food Catering" (Helios Catering) sh.p.k.

SUBJEKT I INTERESUAR: Kostandin Shkurti

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 2030, datë 16.3.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 679, datë 30.3.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-534, datë 27.4.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/"f", 134/1/"i" dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/"a", 71/"b", 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit Spartak Gjikdhima, Elion Shkurtaj dhe subjekti i interesuar Kostandin Shkurti janë ortakë të vetëm të shoqërisë "Helios Catering" sh.p.k. Sipas statutit të shoqërisë rezulton se të tre ortakët e shoqërisë janë edhe administratorë të saj. Me vendimin e datës 7.8.2013, asambleja e ortakëve të shoqërisë ka marrë vendimin për shkarkimin nga detyra të administratorit Konstandin Shkurtit. Ky i fundit, duke mos qenë dakord me këtë vendim, i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e konfliktit, duke kërkuar nga kërkuesit Spartak Gjikdhima dhe Elion Shkurtaj (pala e paditur në procesin gjyqësor) që në mënyrë solidare t'i likuidojnë kuotën si pasojë e largimit nga shoqëria pa shkaqe të arsyeshme, t'i paguajnë fitimin e përfituar për vitet 2011–2013, si dhe t'i paguajnë sponsorizimin e bërë për llogari të shoqërisë. Po ashtu, ai ka kërkuar në gjykatë edhe deklarimin të pavlefshëm të vendimit të asamblesë së ortakëve, si dhe detyrimin e të padituve të paguajnë dëmin e pësuar etj.

2. Me vendimin nr. 2030, datë 16. 3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: "*Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Detyrimi i të padituve që në mënyrë solidare t'i paguajnë paditësit vlerën e kuotave të tija në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Helios Catering" sh.p.k. në vlerën 9.108.000 lekë. Detyrimi i të padituve që në mënyrë solidare t'i paguajnë paditësit pjesën e fitimit të pashpërndarë të shoqërisë "Helios*

Catering" sh.p.k. Detyrimi i të paditurve që në mënyrë solidare t'i paguajnë paditësit për vlerat e marra hua nga shoqëria "Helios Catering" sh.p.k. në masën 9.174.725 lekë. Shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të ortakëve të shoqërisë "Helios Catering" sh.p.k. të marrë në mbledhjen e datës 7.10.2013 dhe detyrimi i të paditurve të paguajnë për dëmin e pësuar si rezultat i këtij vendimi në shumën prej 2.752.000 lekë. Detyrimi i të paditurve t'i paguajnë dëmin që konsiston në formën e fitimit të munguar nga ekzekutimi i kontratave të lidhura me të tretët ... Shuarjen për paditësin Kostandin Shkurti të të gjitha të drejtave, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqërinë "Helios Catering" sh.p.k. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj.".

3. Me vendimin nr. 679, datë 30.3.2016, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur të lërë në fuqi vendimin nr. 2030, datë 16.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kërkuesit Spartak Gjikdhima dhe Elion Shkurtaj.

4. Me vendimin nr. 00-2017-534, datë 27.4.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

5. ***Kërkuesit Spartak Gjikdhima, Elion Shkurtaj dhe shoqëria "Food Catering" sh.p.k.*** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të kërkesës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

5.1 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi në shkallë të parë çështja është gjykuar nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që sipas vlerës së padisë duhet të gjykohej nga një trupë prej tre gjyqtarësh.

5.2 Është cenuar e drejta për t'u dëgjuar në gjykatë. Mosnjoftimi për procesin gjyqësor u ka cenuar kërkuesve të drejtën e mbrojtjes në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe atij të kontradiktoritetit. Padijenia për zhvillimin e proceseve gjyqësore ka qenë rrjedhojë e mosnjoftimit të kërkuesve, e vërtetuar kjo edhe nga vendimet gjyqësore, si dhe nga procesverbali i gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5.3 Vendimi i Gjykatës së Apelit karakterizohet nga mungesa e arsyetimit dhe shkelja e parimit të barazisë së armëve dhe aksesit në gjykatë. Gjykata e Apelit jo vetëm që nuk ka marrë në konsideratë provat dhe ligjin, por dhe vetë ankimin, duke mos u dhënë përgjigje çështjeve të ngritura në të.

5.4 Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit, si dhe e drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, pasi Gjykata e Lartë dhe pse shkaqet ligjore të ngritura në rekurs lidheshin me shkelje të rënda procedurale, ka vendosur mospranimin e tij në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve.

6. ***Subjekti i interesuar Konstandin Shkurti***, në prapësimet me shkrim ka argumentuar sa vijon:

6.1 Pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nuk qëndron. Në kohën e ngritjes së kërkesëpadisë është kërkuar nga ana e palës së paditur një vlerë e përafërt që korrespondon me vlerën e kuotave të paditësit në shoqëri. Gjatë gjykimit, me kërkesë të paditësit, është caktuar një ekspert kontabël dhe në bazë të konkluzioneve të aktit të ekspertimit është bërë ndryshimi i objektit të kërkesëpadisë me vlerë të përcaktuar saktë. Nga ana e palës së paditur nuk është kërkuar në seancë gjyqësore që gjykimi të zhvillohej me tre gjyqtarë. Për më tepër, neni 35 i KPC-së nuk është dispozitë urdhëruese, por u jep të drejtë palëve ta kërkojnë një gjë të tillë.

6.2 I pabazuar është edhe pretendimi i kërkuesve se nuk kanë pasur dijeni për procesin gjyqësor. Nga procesverbalet gjyqësore rezulton se të paditurit kanë pasur dijeni për gjykimin dhe se ata vetë, me kërkesa të vazhdueshme, janë përpjekur të zvarrisin gjykimin. Po ashtu, çdo provë e administruar në gjykim i është nënshtruar debatit gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe palës së paditur i është dhënë mundësia të debatojë mbi to në respektim të parimit të kontradiktoritetit në gjykim.

6.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës se Apelit, rezulton se ai është i mbështetur vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, është logjik në formë dhe në përmbajtje dhe nuk ka asnjë kundërthënie. Pretendimet e palëve, provat dhe faktet janë interpretuar drejt dhe në harmoni me ligjin nga gjykatat e të tria shkallëve të gjykimit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

7. Kërkuesit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/"f" dhe 134/1/"i" të Kushtetutës dhe *ratione temporis,* pasi kërkesa është

paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/"a" i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

8. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae,* sipas nenit 131/1/"f" të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 28, datë 30.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, pasi në gjykatën e shkallës së parë çështja është gjykuar nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që sipas vlerës së padisë duhet të gjykohej nga një trupë prej tre gjyqtarësh. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi, vëren se ky pretendim i kërkuesve nuk është ngritur më parë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për sa kohë që ky pretendim nuk i është nënshtruar vlerësimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe nuk është mbajtur prej tyre një qëndrim përfundimtar në lidhje me të, ai nuk mund të merret në shqyrtim nga kjo Gjykatë, pasi kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet ligjore në dispozicion.

10. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata vlerëson se ato janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimi të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

11. Sipas kërkuesve, ata nuk janë njoftuar për zhvillimin e procesit gjyqësor, për rrjedhojë është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit. Padijenia për zhvillimin e seancave gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë vërtetohet edhe nga vendimet gjyqësore, si dhe nga procesverbali i gjykimit në atë gjykatë.

12. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 30, datë 30.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. E drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e

një procesi të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

14. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar prej saj, vëren se në datën 23.2.2015, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me të dyja palët prezent ka shtyrë seancën për në datën 5.3.2015. Në datën 5.3.2015 është verifikuar prezenca e palëve dhe av. S.H. i palës së paditur "Helios Catering" nuk është paraqitur, megjithëse ka pasur dijeni. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të nenit 179 të KPC-së, ka vendosur ta zhvillojë gjykimin në mungesë të palës së paditur në kushtet kur është provuar se ka dijeni dhe pa shkaqe të arsyeshme nuk është paraqitur.

15. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi për padijeni për zhvillimin e seancave gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk vërtetohet nga vendimet gjyqësore, si dhe nga procesverbali i gjykimit në atë gjykatë, e për këtë arsye ky pretendim është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

16. Sipas kërkuesve, vendimi i Gjykatës së Apelit nuk është i arsyetuar, pasi jo vetëm që nuk ka marrë në konsideratë provat dhe ligjin, por as ankimin, duke mos u dhënë përgjigje çështjeve të ngritura në të.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë *(shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërish të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar *(shih vendimin nr. 10, datë 13.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

19. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Apelit është haptazi i pabazuar. Duke vlerësuar përmbajtjen e këtij vendimi në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër.

Ç. Për pretendimin për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë

20. Sipas kërkuesve edhe pse shkaqet ligjore të ngritura në rekurs lidheshin me shkelje të rënda procedurale, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve.

21. Sipas nenit 133/2 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese merr vendim përfundimtar me

shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. Kjo dispozitë kushtetuese është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 72/2 të ligjit organik të Gjykatës, sipas të cilit vendimet e saj merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj dhe abstenimi nuk lejohet. Në lidhje me thelbin e këtij pretendimi të paraqitur nga kërkuesit, Gjykata, gjatë votimit, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj të kërkuar nga dispozitat e mësipërme. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 73/4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në kushtet kur nuk është formuar shumica e kërkuar prej 5 votash, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.[1]

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/"f" dhe 134/1/"i" të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

[1] Votuan pro pranimit të kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Besnik Imeraj. Votuan për rrëzimin e kërkesës: Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, dhe Fatos Lulo.

VENDIM
Nr. 24, datë 11.5.2018

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 11.5.2018, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar
Denar Biba	zëvendëskryetar
Bledar Skënderi	anëtar
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar
Hysen Osmanaj	anëtar
Vera Shtjefni	Anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Saimir Bashkim Tahiri.

Kërkuesi: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Nëpërmjet shkresës nr. 1570/1 prot., datë 7.5.2018, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit z. Saimir Bashkim Tahiri, deputet i zonës zgjedhore, qarku Tiranë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se, në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për

dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.07.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017, ka fituar 18 (tetëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, është si më poshtë: me numër rendor 1 (një), znj. Elona Shpetim Hoxha/Gjebrea; me numër rendor 2 (dy), z. Besnik Mitat Baraj; me numër rendor 3 (tre), znj. Olta Anxhelo Xhaçka; me numër rendor 4 (katër), znj. Blerina Guri Gjylameti; me numër rendor 5 (pesë), z. Pandeli Sotir Majko; me numër rendor 6 (gjashtë), z. Saimir Bashkim Tahiri; me numër rendor 7 (shtatë), znj. Vasilika Llambi Hysi; me numër rendor 8 (tetë), z. Ervin Alfred Bushati; me numër rendor 9 (nëntë), znj. Ogerta Dhionis Manastirliu; me numër rendor 10 (dhjetë), z. Fatmir Sezai Xhafaj; me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë), z. Rakip Bajram Suli; me numër rendor 12 (dymbëdhjetë), z. Arben Novruz Ahmetaj; me numër rendor 13 (trembëdhjetë), z. Xhemal Myslim Qefalia; me numër rendor 14 (katërmbëdhjetë), z. Sadri Ismail Abazi; me numër rendor 15 (pesëmbëdhjetë), z. Ulsi Qerim Manja; me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë), znj. Klotilda Fatmir Bushka; me numër rendor 17 (shtatëmbëdhjetë), z. Sadi Mehdi Vorpsi; me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Arben Servet Pëllumbi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë.

Në bazë të nenit 164, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Tiranë, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), z. Spartak Brahim Braho.

Referuar nenit 11, të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Spartak Brahim Braho, referuar ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 8.5.2018, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2057.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Spartak Brahim Braho, rezulton se:

- Në pikën "B" të formularit të vetëdeklarimit, "Gjenealitete të mëparshme", ka deklaruar se: ka ndryshuar emrin nga "Zylyftar" në "Spartak" (ndryshuar rreth vitit 1957, si dhe nuk mbahet mend viti i saktë, si dhe akti i ndryshimit të gjendjes civile);

- Në pikën 1 të formularit të vetëdeklarimit, "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?" është përgjigjur me "Po", duke deklaruar, se me vendimin nr. 1397, datë 22.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dënuar për veprën penale "Shpifje", parashikuar nga neni 120/2, Kodi Penal të Kohës dhe ndaj tij është vendosur masa e dënimit me gjobë në shumën 10.000 (dhjetë mijë) lekë;

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe

kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 792 prot., datë 9.5.2018, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe, me shkresën nr. 790 prot., datë 9.5.2018, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Spartak Brahim Braho, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vëtëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. 1206/1 prot., datë 10.5.2018, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Spartak Brahim Braho, sipas së cilës rezulton se me vendimin nr. 1397, datë 22.12.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale "Shpifje", parashikuar nga neni 120/2 e Kodi Penal, dënuar me 10.000 (dhjetë mijë) lekë gjobë. Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është rehabilituar.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e e vetëdeklarimit, të z. Spartak Brahim Braho dhe informacionit të ardhur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore Tiranë, rezulton se dënimi me 10.000 (dhjetë mijë) lekë gjobë, pasi është deklaruar fajtor për veprën penale "Shpifje", parashikuar nga neni 120/2, i Kodit Penal, me vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), z. Spartak Brahim Braho.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a" dhe në nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, z. Spartak Brahim Braho.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM
Nr. 98, datë 30.4.2018

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS PËR SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 5, të VKM-së nr. 244 datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar m vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s për miratimin e kontratës tip për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 3998/1 prot., datë 6.3.2018, ka përcjellë në ERE draftin e "Kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018".

- Në datë 7.3.2018, u depozitua në ERE shkresa e shoqërisë KESH sh.a. me nr. 1017/3, datë 7.3.2018 dhe nr. 186/7 prot., datë 7.3.2018 të ERE-s me "Draftkontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018".

- KESH sh.a. bën me dije se pavarësisht diskutimeve për të arritur në një draft të dakordësuar të kësaj kontrate, ka pasur dispozita të saj të cilat nuk kanë gjetur dakordësinë e Palëve.

- Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", ndryshuar me VKM-në nr. 729, datë 8.12.2017 përcaktohet se: kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE.

- Me vendimin nr. 56, datë 9.3.2018, bordi i ERE-s vendosi "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Draftkontratës tip për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018".

- Në vijim të konstatimeve sa më sipër, në datën 30.3.2018, ERE organizoi një seancë dëgjimore me palët e interesit, ku nuk mungoi përfaqësimi nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

- Në seancë, përfaqësuesit e KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. bënë me dije se kanë gjetur dakordësinë në lidhje me përmbajtjen e nenit 4 dhe me shkresën nr. 7195/1 prot., datë 26.4.2018, OSHEE sh.a. ka përcjellë në ERE draftkontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018, me propozimin e saj final.

- Nga shqyrtimi i propozimeve të sjella nga palët, në lidhje me përmbajtjen e nenit 4 të kësaj kontrate, konstatojmë se sa parashikuar në përmbajtjen e këtij vendosja e një afati më tolerant, prej 10 ditësh për paraqitjen e faturës u vendos në referencë të marrëveshjeve dhe kontratave të tjera të ngjashme.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2018.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Nr. __ prot., datë __.__.2018 Nr. ____ prot., datë __.__.2018

KONTRATË

NDËRMJET KESH SHA DHE OSHEE SHA/OSSH PËR SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018

E lidhur sot në datën ___.___.2018, ndërmjet:

Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, KESH sh.a., regjistruar si person juridik me vendimin nr. 12728, datë 6.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në rrugën "Eshref Frashëri", kompleksi Vizion, nr. 8, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i J61817005F, e përfaqësuar nga z. Agron Hetoja, administrator i shoqërisë KESH sh.a., që më poshtë do të quhet "Shitësi",

dhe

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a./OSSH), regjistruar si person juridik me vendimin nr. 38587, datë 19.6.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në bulevardin "Gjergj Fishta", ndërtesa nr. 88 H.I, Njësia Administrative nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i K72410014H, përfaqësuar nga _____, që më poshtë quhet "Blerësi",

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si "Palët" dhe më vete si "Pala").

Baza ligjore: ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimi nr. 244, datë 30.3.2016, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar, vendimi i bordit të ERE-s nr. 139/2016 "Për miratimin e rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike", i ndryshuar, vendimi i bordit të ERE-s nr. 193/2017 "Për miratimin e rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", ligji nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", i ndryshuar.

Në kushtet kur në pikën 4, të nenit 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar, parashikohet se: "Sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas pikës 2, të këtij neni, i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit mesatar të Bursës Hungareze, HUPX, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse dhe përcaktohet, në mënyrë të detajuar, në kontratë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE".

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

KESH sh.a., i cili më poshtë do të quhet "Shitësi/Furnizuesi" dhe OSHEE sh.a./OSSH (në funksionin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes), që më poshtë do të quhet "Blerësi", lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë me objekt shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.

Neni 2
Detyrimet kryesore të palëve

1. OSHEE sh.a./OSSH, përpara çeljes së procedurës së blerjes në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të njoftojë KESH sh.a. për sasinë e energjisë elektrike që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar me këtë rast KESH sh.a. informacion mbi mundësinë që kjo e fundit ka për të furnizuar sasinë e energjisë elektrike që kjo e fundit mund t'i shesë për mbulimin e tyre, sasi e cila mund të mbulojë pjesërisht apo plotësisht kërkesën për mbulimin e humbjeve.

KESH sh.a., përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike, pasi ka përmbushur detyrimin kontraktual për FSHU-në për furnizimin e klientëve fundorë, do t'i komunikojë shoqërisë OSHEE sh.a./OSSH mundësinë e furnizimit me energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energjisë elektrike të ofruar nga KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve.

2. Nëse të dyja palët bien dakord për shitjen/livrimin e plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, atëherë programimet, nominimet, konfirmimet, livrimi dhe matja do të bazohen në Rregullat në fuqi të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim.

Neni 3
Çmimi

Çmimi për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jetë çmimi mesatar i Bursës Hungarez HUPX për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë elektrike për produktin/profilin band, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse.

Neni 4
Faturimi dhe pagesa

1. Blerësi, brenda datës 5 të muajit kalendarik pas livrimit të energjisë elektrike, do t'i konfirmojë me shkrim shitësit informacion mbi sasinë e energjisë elektrike që ka rezultuar e furnizuar për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Shitësi do t'i lëshojë Blerësit, brenda datës 10 të muajit kalendarik pas livrimit të energjisë elektrike, një faturë ku të pasqyrohet sasia dhe vlera totale e energjisë elektrike që ka rezultuar e livruar për mbulimin e humbjeve në sistemin shpërndarjes gjatë periudhës përkatëse.

3. Pagesa e faturës nga ana e Blerësit, do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e lëshimit të faturës përkatëse nga ana e Shitësit dhe nëse dita e fundit nuk është ditë pune, ditën tjetër të punës.

4. Vonesa në kryerjen e pagesës; Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 5
Mosperformanca për shkak të Forcës Madhore apo pamjaftueshmërisë së plotësimit të kërkesës për klientët tariforë

1. Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese"), që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:

a) Defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterike të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose

b) Pezullimi nga OST-ja përkatëse e livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me programimin sipas kontratës;

c) Defektet apo ndërprerjet në rrjetin e shpërndarjes;

d) Defektet apo ndërprerjet në sistemin e gjenerimit të KESH sh.a.

2. KESH sh.a. nuk do të shesë/livrojë energji elektrike për OSHEE sh.a./OSSH për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në kushtet kur e ka të pamundur plotësimin e sasisë kontraktuale me FSHU-në për furnizimin e klientëve fundorë.

3. Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore apo pamundësisë objektive, të përcaktuara në këtë kontratë, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasitë e palivruara ose të pamarra.

4.Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimit të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

5. Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të livrimit.

6.Në rast të moslivrimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Shitësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Shitësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Blerësit një shumë për sasinë e moslivruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimin më të lartë, nëse ka një të tillë, me të cilin Blerësi e ka blerë ose do ta blinte sasinë e palivruar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë së cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.

7. Në rast të mospranimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Blerësit, sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Blerësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Shitësit një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimin më të ulët, nëse ka një të tillë, me të cilin Shitësi e ka shitur ose do ta shiste sasinë e papranuar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë së cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.

Neni 6

Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi i RSH-së.

2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me kontratën do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë, gjithashtu, zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7

Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme

1. Kjo kontratë, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga ERE dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2018.

2. Ajo mund të përfundohet, ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin nga ERE.

Neni 8

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barasvlershme, 2 (dy) për secilën palë.

kesh Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
Energji e pastër që nuk shteron!

ADMINISTRATORI
Agron Hetoja

OSHEE Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

ADMINISTRATORI

VENDIM
Nr. 99, datë 30.4.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT PËR KËRKESAT E LIDHJES ME RRJETIN E SISTEMEVE ME TENSION TË LARTË ME RRYMË TË VAZHDUAR DHE PARQET ME MODULE TË ENERGJISË TË LIDHUR ME RRYMË TË VAZHDUAR (HVDC)

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, germa "b", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016", si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/04/PHLG-EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të Rrjetit për kërkesat e lidhjes me rrjetin të sistemeve me tension të lartë me rrymë të vazhduar dhe parqet me module të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar (HVDC),

Dhe pasi mori në konsideratë:

- Se Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 1.7.2006;
- Rregulloren e (BE) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2016/1447 e datës 26 gusht 2016, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Vendimit nr. 2018/04/PHLG-EnC, datë 12.1.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë;
- Parashikimet e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike";
- Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.;
- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E;
- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod propozohet për miratim në ERE nga OST sh.a. dhe duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij. Dispozitat e këtij Kodi do të prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të bordit të ERE-s dhe çdo akti tjetër rregullator të sektorit të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Kodit të Rrjetit për kërkesat e lidhjes me rrjetin e sistemeve me tension të lartë me rrymë të vazhduar dhe parqet me module të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar (HVDC).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 100, datë 30.4.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT MBI KËRKESAT PËR LIDHJEN ME RRJETIN E GJENERUESVE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, germa "b", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016", si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/03/PHLG-EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve,

Dhe pasi mori në konsideratë:

- Se Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 1.7.2006;
- Rregulloren e (BE) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE)

2016/631 e datës 14 prill 2016, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;

- Vendimit nr. 2018/03/PHLG-EnC, datë 12.1.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë;

- Parashikimet e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike";

- Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.;

- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E;

- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod propozohet për miratim në ERE nga OST sh.a. dhe duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij. Dispozitat e këtij Kodi do të prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të bordit të ERE-s dhe çdo akti tjetër rregullator i sektorit të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 101, datë 30.4.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT PËR NGARKESËN

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, germa "b", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016", si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/05/PHLG-EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të Rrjetit për Ngarkesën,

dhe pasi mori në konsideratë:

- Se Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 1.7.2006;

- Rregulloren e (BE) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;

- Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2016/1388, datë 17 gusht 2016, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;

- Vendimit nr. 2018/05/PHLG-EnC, datë 12.1.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë;

- Parashikimet e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike";

- Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.;

- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E;

- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod propozohet për miratim në ERE nga OST sh.a. dhe duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij. Dispozitat e këtij Kodi do të prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të bordit të ERE-s dhe çdo akti tjetër rregullator të sektorit të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Kodit të Rrjetit për ngarkesën.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 102, datë 30.4.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "KONTRATËS PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË BALANCIMIT (KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE) TË SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018" MIDIS OST SHA DHE KESH SHA

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "h" dhe nenit 62, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar; "Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, si dhe nenit 19 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 23.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me kontratën nr. 1740/1 prot., datë 29.3.2018 i KESH sh.a. dhe nr. 2358 prot., datë 29.3.2018, i OST sh.a., "Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018, midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.",

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 1740/2 prot., datë 30.3.2018, shoqëria KESH sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e kontratës me nr. 1740/1, datë 29.3.2018 për shoqërinë KESH sh.a. dhe nr. 2358 prot., për shoqërinë OST sh.a. "Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik", për periudhën 1.1.2018–31.12.2018, të nënshkruar nga shoqëritë OST sh.a. dhe KESH sh.a.".

- ERE, në zbatim të neneve 20, germa "h", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", ka autoritetin për të miratuar kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

- ERE, me vendimin nr. 194, datë 30.12.2016, ka vendosur "Miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat" për periudhën 1.1.2018–31.12.2018".

- OST sh.a. në korrespondencë zyrtare ka bërë me dije se shërbimet ndihmëse dhe të balancimit mund të sigurohen vetëm nga njësitë gjeneruese në kaskadën e lumit Drin, Fierzë dhe Vau i Dejës. Subjektet e tjera, të cilët kanë ndërtuar njësi gjenerimi të energjisë elektrike nuk kanë të instaluara pajisjet e nevojshme për të realizuar këtë proces. OST sh.a. bën me dije se KESH sh.a. është siguruesi më eficient dhe konstant i energjisë elektrike për qëllimet sa më sipër shpjeguar, e që nuk rëndon në rritjen e kostove të OST sh.a.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 3752/1 prot., datë 26.12.2017 ka sugjeruar duke iu përmbajtur parashikimeve të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, që çmimi i vendosur sipas rregullave të tregut për sa i përket kontratës dypalëshe për sigurimin e shërbimit të balancimit dhe shërbimeve ndihmëse ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., duhet të bazohet në çmimin mesatar vjetor të ditës në avancë (DAM) të Bursës Hungareze HUPX në momentin e nënshkrimit së kontratës dypalëshe.

- Kontrata e dërguar nga shoqëria KESH sh.a. dhe e nënshkruar nga përfaqësuesit e të dyja palëve, në tërësinë e saj është në përputhje me ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; me VKM-në nr. 244, datë 30.3.2015 "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar; "Rregullat e përkohshme të tregut të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016; "Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017; "Kodin e Transmetimit", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186 datë 10.11.2017; vendimet nr. 23, datë 25.3.2009 dhe nr. 34, datë 13.05.2014, me të cilat ERE ka vendosur rinovimin përkatësisht të licencave për prodhimin dhe tregtimin të energjisë elektrike,

për KESH sh.a. (ndryshuar me vendimin nr. 97, datë 17.6.2016, "Mbi miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike" dhe vendimin nr. 99, datë 17.6.2016, "Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike", vendimin e bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, "Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.", vendimin e bordit të ERE-s nr. 134, datë 6.9.2017 "Mbi licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a., në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", si dhe ka dakordësinë e tyre.

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e kontratës "Për sigurimin e shërbimeve të balancimit kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.", duke pasur parasysh që licenca e shoqërisë OST sh.a., në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 134, datë 6.9.2017 dhe licenca e shoqërisë KESH sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 99, datë 17.6.2016.

- Çmimi për sigurimin e kapacitetit të rezervës së restaurimit të frekuencës në drejtim ngritje/ulje është 270 lekë/mw/h. Çmimi për sigurimin e kapacitetit të rezervës zëvendësuese (RR) është 400 lekë/mw/h. Çmimi i ofrimit të energjisë balancuese është ai i miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017 "Mbi miratimin e rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës "Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 103, datë 30.4.2018

MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË SË OST SHA

Në mbështetje të neneve 16 dhe 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe vendimit të bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, "Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë", bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi miratimin e Programit të pajtueshmërisë së OST sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, ka miratuar certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.

- Në vendimin nr. 43, datë 15.3.2017 të bordit të ERE-s, është parashikuar që, Programi i pajtueshmërisë duhet t'i dorëzohet autoritetit rregullator ERE, jo më vonë se 6 muaj pas caktimit të zyrtarit të pajtueshmërisë. Ndërkohë që zyrtari i pajtueshmërisë duhet të caktohet jo më vonë se 3 muaj pas miratimit të vendimit final të certifikimit.

- Me vendimin nr. 147, datë 28.9.2017, bordi i ERE-s ka vendosur për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të zyrtarit të pajtueshmërisë të propozuar nga OST sh.a.

- Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë OST sh.a., me vendimin nr. 2, datë 21.1.2018 ka miratuar Programin e pajtueshmërisë së OST sh.a.

- Shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 962 prot., datë 31.1.2018 i është drejtuar ERE-s me kërkesën për miratimin e Programit të pajtueshmërisë së OST sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 46, datë 7.3.2018, filloi procedurën për miratimin e Programit të pajtueshmërisë së OST sh.a.

- Ky vendim u publikua në shtypin e shkruar me qëllim marrjen e komenteve dhe opinionit të palëve të interesit mbi këtë vendimmarrje.

- Ky vendim i ERE-s për fillimin e procedurës së miratimit të Programit të pajtueshmërisë së OST sh.a. iu dërgua për mendim Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

- Në përfundim të afateve parashikuara rezulton se nuk ka ardhur asnjë koment apo sugjerim mbi këtë program dhe vendimmarrjen e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin e pajtueshmërisë së OST sh.a. (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a., Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

MIRATUAR
me vendimin nr. [ ], datë [ ] [ ] viti 2018 të Këshillit Mbikëqyrës të OST-së

MIRATUAR
me vendimin nr. [ ], datë [ ] [ ] viti 2018 të bordit të Komisionerëve të ERE-s

PROGRAMI I PAJTUESHMËRISË I OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR ENERGJINË ELEKTRIKE

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST SHA

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky Program pajtueshmërie (këtu dhe më poshtë "Programi") i Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike (këtu dhe më poshtë "OST") vendos kushtet për ndarjen dhe pavarësinë e OST-së sipas ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe ka për qëllim të përcaktojë masat që duhet të ndërmerren për të siguruar përjashtimin e sjelljeve diskriminuese në aktivitetet e OST-së, si dhe të përcaktojë detyrimet specifike të punonjësve të OST-së për të përmbushur objektivat e përcaktuar në këtë dokument dhe kërkesat për zbatimin dhe monitorimin e këtij Programi.

2. Ky Program ka si qëllim të sigurojë:

2.1 Ndarjen e duhur dhe pavarësinë e OST-së;

2.2 Të shmangë sjelljet diskriminuese të OST-së ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të energjisë elektrike (këtu dhe më poshtë "pjesëmarrësit") dhe përdoruesve të rrjetit;

2.3 Prezantimi i një mekanizmi për zbatimin e këtij Programi dhe përcaktimi i detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OST-së në lidhje me këtë Program; dhe

2.4 Prezantimi i një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

3. Të gjithë termat e këtij Programi duhet të përdoren në kuptimin e përshkruar në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

II. STATUSI LIGJOR DHE STRUKTURA E SHOQËRISË

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit - OST sh.a. është krijuar dhe funksionon në formën e

shoqërisë aksionare në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31935, datë 17.4.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. OST sh.a. është e organizuar në formën e shoqërisë aksionare me kapital 100% shtetëror me aksionar të vetëm Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si përfaqësuese të shtetit si pronar të aksioneve të OST sh.a., sipas përcaktimit të bërë në VKM-në nr. 317, datë 24.7.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike".

3. Referuar pikës 2 të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) është MZHETTS-ja (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes).

Gjithashtu, në pikën 1, të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, është përcaktuar se: Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. është MEI (Ministria e Energjisë dhe Industrisë, aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë).

Në vijim, në pikat 3 dhe 5, të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, është përcaktuar se:

Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Nga sa më sipër, si dhe duke qenë se aktivitetet e transmetimit, prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike zhvillohen nga subjekte të organizuara në formën e shoqërive tregtare (shoqëri aksionare shtetërore), autoritetet e përmendura më lart, kryejnë funksionin e Asamblesë së Aksionarëve për shoqëritë respektive, duke marrë çdo vendim që ka në kompetencë Asambleja e Aksionarëve në një shoqëri anonime sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (sot emërtuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të VKM-së nr. 504, datë 13.9.2017 dhe VKM-së nr. 503, datë 13.9.207) janë dy organe të larta të administratës shtetërore të organizuara sipas ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

Ligji nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, nëpërmjet përcaktimit të kritereve për krijimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore.

Në nenin 4 "Organet dhe institucionet e administratës shtetërore" është përcaktuar se:

1. Kryeministri dhe ministrat janë organe të larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione:

a) Kryeministria;

b) Ministritë;

c) Institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave;

ç) Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve;

d) Agjencitë autonome;

dh) Administrata e prefektit.

Marrëdhëniet ndërmjet ministrive dhe Këshillit të Ministrave, përcaktohen në nenin 5 "Ministritë", si më poshtë:

1. Çdo ministri drejtohet dhe përfaqësohet nga ministri, në vazhdim ministri përgjegjës. Ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome, më poshtë "sistem ministror", brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore në përgjegjësinë e çdo ministrie, në vazhdim "fusha e përgjegjësisë shtetërore".

3. Ministria kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, përveç atyre që u

delegohen shprehimisht institucioneve të varësisë apo u ngarkohen me ligj agjencive autonome.

Pra, sa më sipër, secila prej ministrive kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore.

- Fusha përkatëse e përgjegjësisë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është përcaktuar në vendimin nr. 504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë" dhe, konkretisht:

"II. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë.

III. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

…….9. Sektorin e energjisë, burimeve energjetike, përfshirë edhe burimet e rinovueshme të energjisë, eficiencën e energjisë dhe ndryshimet klimatike.

……."

- Legjislacioni përkatës, në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë e saj Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në sektorin e energjisë elektrike, është ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Konkretisht roli i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në raport me OST sh.a. është i përcaktuar në nenet si më poshtë të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike":

Në nenin 4 "Politikat e sektorit të energjisë elektrike":

"1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike të Shqipërisë, në përputhje me politikat e zhvillimit ekonomik dhe sektorët e tjerë të vendit".

2. Ministria përgjegjëse për energjinë:

a) Harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe rrugët e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë;

b) Harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë;

c) Vlerëson nevojën e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese dhe fuqizimin e rrjeteve, në përputhje me programet afatmesme, duke marrë parasysh:

i) bilancet e përgjithshme të pritshme të energjisë elektrike në të ardhmen;

ii) sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike;

iii) koston, duke përfshirë çdo mekanizëm të minimizimit të saj, për këto kapacitete të reja prodhuese;

ç) Mbikëqyr zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit energjetik, në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Në nenin 5 "Të dhëna dhe informacione për bilancin e energjisë elektrike":

"1. Çdo person fizik ose juridik që prodhon, transmeton, shpërndan, importon, eksporton ose furnizon energji elektrike është i detyruar të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë të dhëna lidhur me veprimtarinë e tij, me qëllim hartimin e politikave të zhvillimit të sektorit energjetik dhe komunikimin me institucionet e specializuara, në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, si dhe përgatitjen dhe publikimin e bilancit vjetor energjetik.

2. Ministri përgjegjës për energjinë miraton mënyrën dhe formatin e raportimit të të dhënave".

Në nenin 6 "Rregullat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike":

"1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim me institucionet ose entet e tjera që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike, miraton rregullat për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, të cilat përfshijnë:

a) Masat për sigurinë e furnizimit me energji elektrike;

b) Masat që ndërmerren për rastet kur rrezikohet siguria e furnizimit;

c) Masat që ndërmerren për rastet e situatave emergjente;

ç) Rolin dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji elektrike".

Në nenin 31 "Ndërtimi i interkonektorëve të rinj":

"1. Linjat e reja të interkoneksjonit që ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë".

Në nenin 33 "Linjat direkte":

"1. Të gjithë prodhuesit dhe furnizuesit e energjisë elektrike, brenda një territori të caktuar, mund të furnizojnë mjediset e tyre, filialet dhe klientët e tyre, nëpërmjet një linje direkte.

2. Linjat direkte, që ndërtohen për eksportimin e energjisë elektrike nga prodhuesi vendas drejt një konsumatori jashtë vendit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas marrjes së mendimit nga ana e ERE-s.

3. Linjat direkte, të cilat ndërtohen për lidhjen e një prodhuesi brenda vendit me një konsumator brenda vendit apo një shoqëri furnizimi që furnizon mjediset e veta apo klientët e vet të kualifikuar, miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë, pas marrjes së mendimit nga ana e ERE-s.

4. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e linjave direkte, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ministri miraton ndërtimin e një linje direkte, edhe në rastet kur aplikuesit i është refuzuar aksesi në rrjet për rastet e parashikuara në nenin 29, të këtij ligji, ose nëse është iniciuar një procedurë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, sipas parashikimeve të nenit 24 të këtij ligji.

6. Ministri refuzon ndërtimin e një linje direkte në rast se dhënia e një autorizimi të tillë, pengon përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik dhe mbrojtjen e klientit, të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji. Argumentet për një refuzim të tillë duhet të jenë të arsyetuara dhe i njoftohen aplikuesit".

Në nenin 34 "Standardet teknike dhe të sigurisë në sektorin elektrik":

"1. Rregullat teknike për projektimin, ndërtimin dhe operimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike, sistemit të transmetimit, sistemit të shpërndarjes, linjave të interkoneksjonit ose linjave direkte në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe rregullat e sigurimit teknik, hartohen nga ministri përgjegjës për energjinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardeve dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Kontrolli i zbatimit dhe mbikëqyrja e rregullave teknike, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, për sektorin e energjisë elektrike, kryhen nga inspektorati përgjegjës në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi".

Në nenin 60 "Zhvillimi i rrjetit të transmetimit":

"1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton një plan dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, në konsultim me palët e interesuara, dhe e paraqet për miratim në ERE.

6. Kur ERE konstaton se Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka realizuar për tri vite, një investim të parashikuar sipas planit 10-vjeçar, dhe gjykon se investimi është i nevojshëm dhe mund të financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, i kërkon atij të marrë një nga këto masa:

a) Të realizojë investimin në fjalë;

b) Të organizojë një procedurë konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori;

c) Të pranojë rritjen e kapitalit, me qëllim financimin e investimeve të nevojshme.

7. Kur ERE merr masa, sipas shkronjës "b", të pikës 6, të këtij neni, mund të detyrojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

a) Të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë;

b) Të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë;

c) Të administrojë asetet e reja pas ndërtimit.

Në këto raste tarifat përkatëse do të mbulojnë kostot e investimeve në fjalë.

8. ERE, në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë".

Së fundmi në nenin 97 "Tregu i energjisë elektrike":

"3. Ministri përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim me palët e interesuara në sektorin e energjisë elektrike dhe pasi merr mendimin e Autoritetit të Konkurrencës, harton modelin e tregut të energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohen të paktën:

a) Mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike;

b) Marrëdhëniet kontraktore të nevojshme;

c) Informacioni dhe shkëmbimi i të dhënave kryesore, të kërkuara mes pjesëmarrësve të tregut".

- Fusha përkatëse e përgjegjësisë së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është përcaktuar në vendimin nr. 503, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë" dhe, konkretisht:

III. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

"…….

17. Administrimin e pronës shtetërore;

……."

VII. Ministria e Financave dhe Ekonomisë përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit brenda fushës së përgjegjësisë, sipas pikës III të këtij vendimi.

- Për sa i përket rolit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes) në raport me OST sh.a., shpjegojmë si më poshtë:

Rezulton se Operatori i Sistemit të Transmetimit, OST sh.a. është e organizuar në formën e një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror. Kjo në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", ku në nenin 53, është përcaktuar se:

"- Operatori i Sistemit të Transmetimit:

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, i cili duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e prodhimit apo furnizimit, në kuptim të nenit 54 të ligjit".

Në zbatim të pikës 3, të nenit 53, të këtij ligji, është miratuar VKM-ja nr. 317 datë 27.14.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", e cila ka përcaktuar Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë si autoritetin publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).

Në pikën 3 të VKM-së përcaktohet se ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Po kështu, në nenin 1, të ligjit nr. 8/2016, "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar", është përcaktuar se:

"Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektroenergjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

Pra, nga përcaktimet e përmendura këtu më lart, rezulton se secila nga ministritë e përmendura duhet të kryejë funksionin e pronarit të aksioneve në shoqëritë përkatëse.

Për më tepër sqarojmë se, organizimi i tërë veprimtarisë ekonomike në Shqipëri rregullohet nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Ky ligj përcakton dhe rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Ky ligj është i detyrueshëm edhe për shoqëritë shtetërore.

OST sh.a. në këndvështrimin e organizimit juridik i është nënshtruar ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Pra, më konkretisht, roli i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë) si autoriteti publik që përfaqëson

shtetin si pronar të aksioneve në raport me OST sh.a., është ai i pronarit të 100% të aksioneve. Kjo ministri sillet ndaj shoqërisë OST sh.a. dhe ushtron ato të drejta dhe ka ato detyrime njëlloj si çdo pronar tjetër privat ndaj aksioneve që ka në një shoqëri aksionare që në Shqipëri është ndërtuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Pra, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë) luan rolin e aksionarit të vetëm, duke marrë çdo vendim që ka në kompetencë Asambleja e Përgjithshme në një shoqëri aksionare sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtarë", të ndryshuar.

Këtë rol për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., në bazë të nenit 1, të VKM-së nr. 317, datë 27.14.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", e luan Ministria e Energjisë dhe Industrisë (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë).

Për sa i përket emërimit të Këshillit Mbikëqyrës, në nenin 135 "Të drejtat dhe detyrimet", të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, është përcaktuar se:

2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a) Përcaktimin e politikave tregtare;

b) Ndryshime të statutit;

c) Emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Në statutin e OST sh.a. (neni 13 "Këshilli Mbikëqyrës"), është përcaktuar se:

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Pra, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë) emëron anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. Rezulton se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të OST sh.a. dhe në zbatim të pikës 3, të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", në të cilën është përcaktuar se:

Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka miratuar me urdhër nr. 4911, datë 14.6.2016 "Për ndryshim në Këshillin Mbikëqyrës", anëtarët e rinj të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a.

Po kështu, Ministria e Energjisë dhe Industrisë (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), në cilësinë e pronarit për Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., në zbatim të pikës 3, të VKM-së nr. 317, datë 27.14.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", ka miratuar me urdhrin nr. 210, datë 30.6.2016, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a. dhe me urdhrin nr. 209, datë 30.6.2016, ka miratuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE sh.a.

Për sa më sipër, konkludojmë se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. janë emëruar nga MZHETTS (sot MFE), duke respektuar kufizimet e imponuara nga neni 54 i ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

- Në bazë të nenit 54, në pikat 3, 4, 5, 6, përcaktohet se:

"3. Duke filluar nga data 1 janar 2016, i njëjti person nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë:

a) Të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe të ushtrojë kontroll ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit;

b) Të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e

transmetimit dhe të ushtrojë kontroll ose të ushtrojë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

c) Të emërojë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojë kontroll apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

ç) Të jetë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

4. Ndalimet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të paragrafit më sipër do të zbatohen në mënyrë të veçantë, për:

a) Kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) Kompetencën për të emëruar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) Të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

5. Detyrimi i parashikuar më sipër, konsiderohet se është përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një operator i sistemit të transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

6. Kur personi i përmendur në paragrafin më sipër, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person".

Siç është evidentuar më lart, në bazë të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", rezulton se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është mbajtëse e 100% të aksioneve të OST sh.a., ndërkohë që MEI është 100% aksionare e KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., të cilat ushtrojnë përkatësisht aktivitetin e gjenerimit dhe shpërndarjes së furnizimit universal të energjisë elektrike.

Në këtë mënyrë, për qëllime të ndarjes së pronësisë së OST sh.a., nga aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, rezulton e kryer kjo ndarje sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 54, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në përputhje me sa është përcaktuar në nenin 8, germa "a", të "Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike", ku përcaktohet se, ndër kriteret që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin nga Rregullatori është: a) Personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike nuk duhet të ketë të drejta kontrolli të drejtpërdrejta apo të tërthorta në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjellas".

Në nenin 8, pika 2, germa "b", të rregullores, përcaktohet se: "Personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike nuk emëron, kontrollon apo është anëtar i bordeve apo strukturave drejtuese në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjellas, si dhe nuk ushtron të drejtën e votës apo të drejtën e maxhorancës së aksioneve".

Kjo kërkesë e Rregullores, ka gjetur zgjidhje në kuadër të parashikimeve të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike" dhe urdhrit nr. 4911 datë 14.6.2016 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a., shpjeguar në mënyrë të detajuar më lart.

Në bazë të nenit 54/1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga veprimtaritë e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe

furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

Aktualisht, OST-ja është licencuar për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, referuar vendimit të ERE-s nr. 24, datë 26.3.2009 "Për rinovimin e licencës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike". Sa u takon aktiviteteve të tjera, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi, OST sh.a. nuk rezulton të ushtrojë këto aktivitete.

1. OST sh.a. është bashkëpronare me vota të barabarta e shoqërisë Zyra për Koordinimin e Ankandeve në Evropën Juglindore (Coordinated Auction Office in South East Europe (SEE CAO)). SEE CAO është ndërtuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Qendror të Biznesit, Podgoricë, Mali i Zi, me seli në Podgoricë të Malit të Zi. SEE CAO kryen këto shërbime, alokimin e kapacitetit transmetues në dispozicion (ATC) nëpërmjet proceseve të ankandit të përcaktuara me rregulloren e ankandit, në të dyja drejtimet midis bashkëpronarëve. SEE CAO drejtohet nga një bord drejtoresh ku secila kompani themeluese përcakton përfaqësuesin e saj në bordin e drejtorëve, i cili është përgjegjës për zgjedhjen e drejtorit ekzekutiv të shoqërisë. Për sa u përket marrëdhënieve të biznesit, midis SEE CAO dhe TSO-ve bashkëpronarë, sqarojmë se SEE CAO vepron si agjent kundrejt të gjitha TSO-ve, duke kryer në emër të SEE CAO dhe për llogari e interes të TSO-ve, ankandet e alokimit të kapaciteteve. Kjo marrëdhënie rregullohet sipas përcaktimeve të bëra në marrëveshjen e shërbimit. Ndërsa marrëdhënia kontraktuale për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit rregullohet midis SEE CAO dhe fituesve të dalë nga rezultat e ankandeve.

2. OST sh.a. është e organizuar dhe funksionon si shoqëri tregtare në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, statutit të shoqërisë, si dhe akteve të brendshme të saj organet drejtuese të shoqërisë, janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori që ushtrojnë kompetencat e tyre sipas përcaktimeve të ligjit të lartpërmendur dhe statutit të shoqërisë.

Referuar pikës 2, të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike", autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) është MZHETTS (sot MFE), e cila luan rolin e aksionarit të vetëm të OST sh.a., duke marrë çdo vendim që ka në kompetencë Asambleja e Përgjithshme në një shoqëri aksionare sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Në referim të nenit 135, pika "b", ku përcaktohet që Asambleja e Përgjithshme merr vendime për emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe të nenit 13 të statutit të OST-së, ku përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, MZHEETS-ja, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, ka emëruar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OST-së, duke respektuar parashikimet e pikës 3, të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike" dhe parashikimet e nenit 54, të ligjit nr. 43/2015, siç është shpjeguar hollësisht më lart.

Në bazë të nenit 158 të ligjit ku përcaktohet se Këshilli i Administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet, si dhe nenit 20.1 të statutit të OST sh.a. ku përcaktohet se Këshilli Mbikëqyrës emëron administratorin e shoqërisë, me vendim nr. 17, datë 30.6.2017 është riemëruar administratori i OST sh.a., nga Këshilli i ri i sipërpërmendur.

3. Struktura organizative e OST sh.a., e miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 30, datë 11.10.2017, është konceptuar me disa drejtori që kryejnë funksione administrative me varësi nga administratori i shoqërisë dhe 4 departamente, 3 nga të cilat lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e detyrave të përcaktuara në nenet 56 dhe 57 të ligjit për sektorin e energjisë dhe 1 departament mbulon funksionet administrative dhe të shërbimeve të përditshme në kompani. Struktura organizative e shoqërisë është si më poshtë:

- Kabineti;
- Drejtoria Ekonomike;
- Drejtoria Ligjore;
- Drejtoria e Projekteve të Huaja (PIU);

- Drejtoria e Energjisë së Transmetuar, Humbur dhe Disbalancave;
- Departamenti i Operimit të Sistemit;
- Departamenti i Operimit të Tregut;
- Departamenti i Rrjetit të Transmetimit;
- Departamenti i Administrimit.

Drejtoria e Energjisë së Transmetuar, Humbur dhe Disbalancave është e organizuar si drejtori më vete për shkak të rëndësisë së saj dhe si një strukturë e ngarkuar posaçërisht me sigurimin e energjisë për humbjet dhe shërbimet ndihmëse në tregun e energjisë nëpërmjet procedurave konkurruese dhe transparente dhe sigurimin e balancimit të sistemit nëpërmjet organizimit dhe operimit të tregut të disbalancave, konsiderohet si një domosdoshmëri e imponuar nga ligji i ri i sektorit të energjisë dhe një kusht i domosdoshëm për mirëfunksionimin e sektorit të energjisë elektrike, në mënyrë transparente dhe në shmangie të çdo diskriminimi.

Drejtoria e Projekteve të Huaja (PIU, e cila garanton implementimin optimal të projekteve të zhvillimit të rrjetit, të financuara nga komuniteti i donatorëve të huaj, ndjek dhe zbaton legjislacionin përkatës për përmbushjen dhe implementimin e projektit të huaj që në fazat e para të financimit e deri në përfundimin dhe marrjen në dorëzim të veprës.

Departamenti i Operimit të Sistemit është ai që siguron vazhdimësinë dhe besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike duke bërë koordinimin e punës së sistemit të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike, në zbatim të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Modelit dhe Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri dhe të gjitha akteve ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi. Ky departament përfshin 3 drejtori: Drejtoria e Standardeve dhe Kodeve, Drejtoria e Operacioneve dhe Drejtoria e Monitorimit të Tregut.

Departamenti i Operimit të Tregut, me dy drejtori në përbërje të tij: Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Administrimit të Tregut, është konceptuar si një entitet që do të ndahet ligjërisht dhe financiarisht nga OST-ja, me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve të nenit 57/2 të ligjit nr. 43/2015. Ky departament ashtu sikurse janë të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në ligj, është i ngarkuar me operimin e tregut të energjisë elektrike, me organizimin dhe administrimin e pasqyrave financiare të energjisë elektrike mes pjesëmarrësve të tregut, mbajtjen e llogarive në emër të palëve tregtare për transaksionet e shitblerjes së energjisë elektrike midis palëve, menaxhimin e procesit të regjistrimit të palëve në treg, menaxhimin e procesit të propozimit, miratimit dhe çdo amendimi të Rregullave të Tregut në përputhje me ligjin etj.

Departamenti i Rrjetit të Transmetimit menaxhon dhe mbikëqyr aktivitetet e projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit (linjat, nënstacionet dhe sistemet e komunikimit) që garantojnë furnizimin me energji elektrike në mënyrë të sigurt dhe efikase.

Ky departament përfshin tri drejtori:

- Drejtorinë e Zhvillimit të Sistemit, që është përgjegjëse për projektimin, ndërtimin dhe modifikimin e objekteve të rrjetit të transmetimit të OST-së (linjat, nënstacionet dhe objektet ndihmëse) në përputhje me planet e përcaktuara të investimeve dhe përforcimeve, duke i përshtatur ato me kërkesat e planifikimit të sistemit dhe me specifikimet teknike, financiare dhe mjedisore të kompanisë. Ndjek vijueshmërinë dhe zbatimin e projekteve të hartuara ose miratuara nga kjo drejtori, përcakton politikën mjedisore të OST-së dhe siguron zbatimin e saj, me qëllim minimizimin e ndikimit në mjedis të aktiviteteve dhe objekteve të saj dhe kryen veprimet ligjore për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për fillimin e procedurave të shpronësimit dhe regjistrimit të pasurive të paluajtshme të OST-së.
- Drejtorinë e Shfrytëzim-Mirëmbajtjes së Transmetimit, që ka si objekt të punës shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e linjave të transmetimit 400 kV, 220 kV 154 kV dhe 110 kV, e nënstacioneve lidhëse midis tyre dhe të nënstacioneve pranë burimeve prodhuese të energjisë elektrike me tension 220 kV e lartë. Shfrytëzon dhe mirëmban sistemin e telekomunikacionit në shërbim të OST sh.a. dhe të KESH-it, shfrytëzon dhe mirëmban sistemin e matjes së energjisë elektrike, në objektet brenda OST sh.a. dhe, në veçanti, në linjat e interkoneksjonit dhe në kufijtë ndarës me OSHEE-në dhe objektet e prodhimit të KESH-it, si dhe mirëmban sistemin e mbrojtjes.
- Drejtorinë e Monitorimit dhe Koordinimit Rajonal, që është struktura përgjegjëse për

koordinimin dhe monitorimin e aktivitetit midis DSHMT-së, sektorëve në vartësi të saj, NJOP-it e NJMT-së, si dhe sektorëve në vartësi të tyre.

Struktura organizative e shoqërisë gjendet bashkëlidhur si shtojcë e këtij Programi.

III. NDARJA DHE PAVARËSIA E OST-së

A. Ndarja e OST-së

1. OST-ja duhet të ndahet nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e energjisë elektrike në përputhje me nenin 54/1, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

2. OST-ja duhet të jetë një person juridik i ndarë që nuk është pjesë e kompanive vertikalisht të integruara ose pjesë e strukturës dhe nuk kryen dhe as nuk është e angazhuar në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

3. Për të siguruar ndarjen e duhur të OST-së, i njëjti person ose të njëjtët persona nuk kanë të drejtë që njëkohësisht:

a) Të ushtrojnë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen e një të licencuari, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo rrjetit të transmetimit;

b) Të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo të ushtrojnë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

c) Të emërojnë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror; dhe

d) Të jenë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

4. Të drejtat të cilat referohen në paragrafin 3 përfshijnë, veçanërisht:

4.1 Kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

4.2 Kompetencën për të emëruar anëtarët e Këshillit mbikëqyrës ose organeve ligjore që përfaqësojnë shoqërinë;

4.3 Të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

B. Pavarësia drejtuese e OST-së

1. Drejtuesit e OST-së, të tillë si kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, administratori dhe personeli drejtues (drejtuesit e njësive strukturore), duhet të jenë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre. Për këtë qëllim, duhet të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

a) Drejtuesit e OST-së nuk duhet të punësohen ose të lidhen profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre;

b) Pagat e drejtuesve të OST-së nuk duhet të vendosen në bazë të aktivitetit apo performancës së kompanive vertikalisht të integruara, por në bazë të strukturës dhe udhëzimit të pagave për punonjësit e OST sh.a., siç specifikohet në aktet e brendshme të shoqërisë dhe në kontratat përkatëse të punësimit;

c) Drejtuesit e OST-së nuk duhet të kenë interes ose të marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.

d) Transferimi i drejtuesve të OST-së te kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre dhe anasjellas, duhet të bëhet sipas kushteve transparente të vendosura qartë në aktet e brendshme të shoqërisë dhe kontratën individuale e punës, të cilat duhet të zbatohen rregullisht;

e) Drejtuesit e OST-së nuk duhet të zotërojnë aksione të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjese të tyre.

C. Pavarësia funksionale dhe vendimmarrëse e OST-së

1. OST-ja duhet të funksionojë si operator i sistemit të transmetimit për energjinë elektrike sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe akteve të tjera ligjore dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

2. Midis të tjerave, OST-ja duhet të jetë përgjegjëse për dhënien dhe menaxhimin e aksesit të palës së tretë, përfshirë mbledhjen e detyrimeve

të aksesit dhe detyrimeve që rrjedhin nga kongjestioni (flukset), për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, si dhe për të siguruar një funksionim afatgjatë të sistemit të transmetimit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planifikimit të investimeve.

3. Me zhvillimin e sistemit të transmetimit, OST-ja duhet të jetë përgjegjëse për planifikimin, ndërtimin dhe komisionimin e infrastrukturës së re.

4. OST-ja duhet të jetë e pavarur në planifikimin e investimeve në lidhje me sistemin e transmetimit sipas kërkesave të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe akteve të tjera ligjore në zbatim, dhe duhet të përputhet me planin e miratuar dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë (këtu dhe më poshtë "ERE").

5. OST-ja duhet të ketë në dispozicion burimet e kërkuara financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike në përputhje me kërkesat për pavarësinë e tij të vendosura në paragrafët 15–18 të këtij Programi.

6. Asnjë nga aktivitetet funksionale të OST-së dhe/ose të drejtat vendimmarrëse nuk mund të ndikohet nga interesat komerciale dhe interesa të tjera të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre.

IV. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE

A. Aksesi në sistemin e transmetimit

1. OST-ja duhet të sigurojë akses të barabartë në sistemin e transmetimit për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të cilët përputhen me kërkesat e vendosura te ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", aktet e tjera ligjore në fuqi dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

2. OST-ja mund të refuzojë dhënien e aksesit në sistemin e transmetimit vetëm në bazë të rasteve të përcaktuara te ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

3. Dhënia e aksesit në sistemin e transmetimit ose refuzimin për të dhënë një akses të tillë, si dhe dispozitat për shërbimet e OST-së, nuk duhet të përfundojë në një trajtim preferencial të pjesëmarrësve dhe përdoruesve të rrjetit ose në të kundërt, nuk duhet të jetë diskriminuese ndaj këtyre pjesëmarrësve të veçantë ose përdoruesve të rrjetit.

4. Punonjësit e OST-së duhet të trajtojnë kërkesat e pjesëmarrësve ose përdoruesve të rrjetit për marrjen e shërbimeve nga OST-ja, në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese, duke mosfavorizuar pjesëmarrësit ose përdoruesit e veçantë të rrjetit, që mund të sjellë një avantazh të padrejtë komercial.

5. Paragrafët 23 dhe 24 duhet të zbatohen për prokurimin dhe shitjen e shërbimeve, për çmimin, aksesin ndaj shërbimeve ekskluzive dhe shërbimeve ndaj të tretëve, duke përfshirë gatishmërinë për ofrimin e shërbimeve të veçanta dhe efikasitetin e tyre.

6. Tarifat dhe detyrimet e tjera për shërbimet e OST-së duhet të rregullohen sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në aktet ligjore në fuqi dhe duhet të publikohen në faqen e OST-së dhe të aplikohen në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit që përmbushin kriteret përkatëse të vendosura në aktet ligjore në fuqi dhe te Kodi i Rrjetit të Transmetimit.

B. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale

1. Aktivitetet e OST-së nuk duhet të kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e energjisë elektrike.

2. Çdo transaksion komercial dhe financiar nga OST-ja, përfshirë huat, kreditë dhe marrëveshjet e tjera financiare, si dhe transaksionet me kompanitë që kanë lidhje, duhet të organizohen sipas kushteve të tregut dhe në asnjë rast ato nuk duhet të ndikojnë negativisht në pavarësinë e OST-së.

3. Në përputhje me detyrimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, OST-ja njofton ERE-n për transaksionet e mbyllura komerciale dhe financiare, duke mbajtur parasysh edhe parashikimet e paragrafit 28 dhe me kërkesën e ERE-s, ofron kopje të këtyre transaksioneve dhe dokumenteve origjinale, ofertave komerciale, deklaratave të pranimit, memorandume, fatura etj.

4. Kopje të të gjitha kontratave të mbyllura nga OST-ja me pjesëmarrësit e tjerë, përdoruesit e rrjetit dhe/ose palëve të tjera të treta dhe dokumente të tjera origjinale (oferta komerciale, deklarata pranimi, memorandume, fatura etj.) duhet të ruhen dhe arkivohen me kujdes te zyrat e OST-së dhe duhet të vendosen në dispozicion të zyrtarit të pajtueshmërisë të kompanisë OST (këtu dhe më poshtë "Zyrtari i pajtueshmërisë").

C. Konflikti i interesit

1. Rastet e konfliktit të interesit do të trajtohen sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike", i ndryshuar, akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre, Kodit të Etikës për punonjësit e OST-së, si dhe përcaktimeve të këtij Programi;

2. Në rastin e një konflikti ekzistues të interesit ose konflikti të mundshëm, drejtuesi ose punonjësi i OST-së duhet të informojë në kohë administratorin dhe zyrtarin e pajtueshmërisë të kompanisë OST, por jo më vonë se dita tjetër e punës, pasi ai/ajo është vënë në dijeni për konfliktin ekzistues të interestit ose ndonjë rrethanë që mund të shkaktojë një konflikt interesi.

3. Konflikti i interesit nënkupton çdo situatë kur ka ndodhur një interes personal i drejtuesit ose punonjësit të OST-së, qoftë ky konflikt direkt përmes personave që kanë lidhje ose një konflikt i papërputhshëm me veçimin, pavarësinë, sjelljet e tregut dhe/ose veprimtaritë funksionale të kompanisë OST, ose konflikt në të cilin drejtuesi ose punonjësi i OST-së është ose mund të jetë në pozicionin për të përfituar nga veprimet ose vendimet e marra si drejtues ose punonjës i OST-së.

4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pas njoftimit për konfliktin e interesit, drejtuesi ose punonjësi në fjalë i OST-së duhet të konsultohet me administratorin ose zyrtarin e pajtueshmërisë së kompanisë OST, për të shmangur ose eliminuar konfliktin e interesit, ose për të përfunduar marrëdhëniet e punës ose ato profesionale me OST-në, në rast dështimi ose mosdashjes së drejtuesit ose punonjësit për të zgjidhur konfliktin ekzistues ose të mundshëm të interesit.

5. Të gjitha kontratat e punësimit ndërmjet OST-së dhe drejtuesve ose punonjësve, si dhe udhëzimeve profesionale për drejtuesit e emëruar, duhet të ofrojnë mundësinë e përfundimit të kontratave të punës ose shkarkimin nga detyra të drejtuesit sipas lirisë së veprimit të kompanisë OST, në rast se nuk mund të ndalohet ose zgjidhet konflikti i interesit ose mosdashjes së drejtuesit ose punonjësit që të zgjidhin konfliktin ekzistues ose konfliktin e mundshëm të interesit.

V. POLITIKA E INFORMACIONIT TË KOMPANISË OST

A. Sigurimi i informacionit

1. OST-ja duhet të sigurojë informacionin funksional dhe informacionin përkatës të sistemit të transmetimit dhe shërbimeve të saj, i cili nuk mbrohet si informacion i ndjeshëm tregtar sipas kushteve dhe termave të akteve ligjore në fuqi dhe këtij Programi. Sigurimi i informacionit duhet të kryhet në mënyrë të drejtë transparente dhe jodiskriminuese. OST-ja duhet të ndalojë sigurimin e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, i cili mund të sjellë avantazhe konkurruese për pjesëmarrësit e veçantë ose përdoruesit e rrjetit. Informacioni publik duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së, si kërkohet nga ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe aktet ligjore në fuqi.

2. OST-ja duhet t'i sigurojë informacion të mjaftueshëm Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe operatorëve të sistemit të transmetimit fqinjë për të siguruar transmetimin dhe furnizimin e sigurt dhe eficient të energjisë elektrike midis sistemeve të ndërlidhura të energjisë elektrike. Ky informacion duhet të sigurohet sipas termave dhe kushte të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", akteve ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit.

3. OST-ja duhet t'u sigurojë pjesëmarrësve dhe përdoruesve të rrjetit informacionin e nevojshëm për akses eficient dhe të pakufizuar te sistemi i transmetimit. Ky informacion duhet të sigurohet në mënyrë jodiskriminuese sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

B. Konfidencialiteti i informacionit

1. OST-ja duhet të sigurojë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të siguruar nga OST-ja gjatë aktiviteteve funksionale dhe/ose komerciale, dhe duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të matura për të shmangur shpërndarjen diskriminuese të informacionit të ndjeshëm tregtar në lidhje me aktivitetet të cilat përmbajnë vlera tregtare për persona të tjerë.

2. Për qëllime të cilave iu jemi referuar në paragrafin 38, informacioni i ndjeshëm tregtar nënkupton:

2.1 Informacioni në lidhje me menaxhimin, funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të

transmetimit, përveç informacionit publik i përkufizuar si i tillë sipas ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe këtij Programi;

2.2 Informacioni që përmban sekrete tregtare dhe informacione të tjera të ndjeshme tregtare të marra nga OST-ja në mënyrë që të kryejë aktivitetet e saj;

2.3 Informacione të tjera të natyrës tregtare, financiare ose teknike, të cilat iu vijnë drejtuesve ose punonjësve të OST-së gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre profesional, që janë informacione të ndjeshme tregtare dhe mund të merren nga pjesëmarrës të ndryshëm, ofrohet si një avantazh konkurrues në tregun e energjisë elektrike; dhe

2.4 Informacioni i klasifikuar si konfidencial ose në konfidencialitet dhe/ose marrëveshjet e fshehta të firmosura nga OST-ja.

3. OST-ja nuk duhet të shpërndajë informacionin e ndjeshëm tregtar te ndonjë palë e tretë, përveç rasteve, kur:

3.1 Shpërndarja e informacionit kërkohet shprehimisht nga ligji, duke siguruar që kjo shpërndarje të kryhet sipas një mënyre të përcaktuar me ligj;

3.2 Një pëlqim paraprak me shkrim për shpërndarjen e informacionit jepet nga personi ndaj të cilit OST-ja është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit; ose

3.3 Kur informacioni nuk është më konfidencial për shkak të shpërndarjes së ligjshme publike të tij.

4. Në rast shpërndarje të informacionit të ndjeshëm tregtar nga OST-ja për ndonjë palë të tretë sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 30, kjo shpërndarje duhet të kryhet në masën e nevojshme që OST-ja të sigurojë shërbimet e saj dhe duhet të jetë në përputhje me konfidencialitetin dhe/ose marrëveshjen për të mos e shpërndarë, e cila vendos detyrimin e palës së tretë për informacionin konfidencial të marrë nga OST-ja, si dhe vendosjen e detyrimeve financiare për këtë palë të tretë në rast të moskryerjes ose zbatimit të papërshtatshëm të detyrimeve konfidenciale.

5. OST-ja duhet të ruajë informacionin konfidencial të cilësuar si të tillë sipas kontratave përkatëse. Këto palë kontraktore duhet të sigurojnë që drejtuesit dhe punonjësit e tyre, që e marrin këtë informacion konfidencial nga OST-ja, duhet të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me këtë informacion dhe nuk e shpërndan atë te ndonjë palë e tretë përveçse kur specifikohet ndryshe në kontratë. Detyrimi për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit duhet të vazhdojë gjatë gjithë kohës së marrëdhënieve kontraktuale dhe pas mbarimit të tyre derisa informacioni konfidencial të shpërndahet publikisht në mënyrë ligjore.

6. Në zbatim të përcaktimeve të Kodit të Etikës për punonjësit e OST sh.a., rregulloreve të brendshme të shoqërisë, si dhe përcaktimeve të këtij Programi, drejtuesit ose punonjësit e OST-së duhet të sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të cilët e kanë në dispozicion për shkak të detyrës profesionale. Veçanërisht, për të siguruar konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar drejtuesit dhe punonjësit e OST-së:

6.1 Nuk duhet t'i lënë materialet që kanë informacion të ndjeshëm tregtar siç janë (dokumentet, arkivues të të dhënave elektronike, kompjuterë, tableta, telefonat etj.) të pambrojtur në vende publike;

6.2 Nuk duhet ta diskutojnë informacionin e ndjeshëm tregtar në publik; dhe

6.3 Kur përdorin postën elektronike ose aplikimet e tjera të komunikimit *online*, me shumë kujdes duhet të kontrollojnë përmbajtjen e mesazhit dhe adresat e marrësit për të shmangur shpërndarjen e mundshme të informacionit të ndjeshëm tregtar te ndonjë palë e tretë.

7. Çdo dokument me shkrim i OST-së, që përmban informacion të ndjeshëm tregtar, duhet të shënohet si i tillë në faqen e parë.

8. Të drejtat e aksesit te sistemet e informacionit dhe databazat e OST-së, si dhe të drejtat e aksesit te disqet dhe dosjet e përbashkëta duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mosfavorizojnë pjesëmarrësit ose përdoruesit e rrjetit. Për këtë arsye, transaksionet *online* ose aksionet që përbëjnë rrezik për shpërndarjen e informacionit të ndjeshëm tregtar duhet të tregohen qartë dhe duhet të mbahet një listë për autorizimet e aksesit nga zyrtari i pajtueshmërisë dhe duhet të përditësohet çdo vit ose më shpesh nëse është e nevojshme.

9. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OST-së, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët nuk duhet të shpërndajnë informacionin e ndjeshëm tregtar te ndonjë palë e tretë gjatë emërimit të tyre, punësimit ose bashkëpunimit me OST-në dhe të paktën 3 (tri) vitet në vazhdim pas mbarimit të emërimit, punësimit, bashkëpunimit deri kur:

9.1 Pëlqimi paraprak për shpërndarjen të jepet nga personi të cilit OST-ja ka detyrimin të ruajë konfidencialitetin e informacionit;

9.2 Informacioni nuk është më konfidencial për shkak të shpërndarjes ligjore publike të tij; ose

9.3 Shpërndarja e informacionit kërkohet nga ligji në fuqi.

10. Në rast shpërndarje sipas paragrafit 36, drejtuesit dhe punonjësit e OST-së, përfaqësuesit e tyre të autorizuar, audituesit dhe këshilltarët janë të detyruar të sigurojnë që informacioni i ndjeshëm tregtar është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit në të njëjtën kohë për të mos i dhënë asnjë personi një avantazh të padrejtë tregtar në tregun e energjisë elektrike.

11. Në përputhje me kërkesat e transparencës të kompanisë OST, duhet të sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të trajtohen në mënyrë jo diskriminuese dhe me kushte të njëjta kur ofrohet informacioni funksional dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me aktivitetet e OST-së. Nëse ndonjë informacion i ndjeshëm tregtar duhet të shpërndahet, duhet të sigurohet që ky informacion është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit duke e publikuar atë në faqen e internetit të OST-së.

12. Marrëveshjet konfidenciale me drejtuesit e emëruar të OST-së, kontratat e punësimit me punonjësit e OST-së, si dhe marrëveshjet e mbyllura midis OST-së dhe përfaqësuesve të saj të autorizuar, audituesve dhe këshilltarëve duhet t'u parashikojnë detyrimet e drejtuesve, punonjësve, përfaqësuesve të autorizuar, audituesve dhe këshilltarëve, që kanë lidhje me konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar dhe duhet të parashikojë detyrimet për dëmshpërblim financiar në rast të moskryerjes ose zbatimit të papërshtatshëm të këtyre detyrimeve.

13. Çdo prishje e detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, si kërkohet sipas këtij Programi dhe kontratave respektive, mund të quhet shkelje e rëndë e detyrimeve të drejtuesve, punonjësve, përfaqësuesve të autorizuar, audituesve ose këshilltarëve, dhe mund t'i japë OST-së të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit.

C. Informacioni publik

1. Informacion publik nënkupton çdo informacion që përgjithësisht njihet se ka një karakter publik, ose çdo informacion tek i cili aplikohen kërkesat për shpërndarjen e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi. Ky informacion nuk mund të klasifikohet si konfidencial ose informacion i ndjeshëm tregtar dhe duhet të vendoset në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve, përdoruesve të rrjetit dhe palëve të tjera të treta.

2. OST-ja duhet të publikojë në faqen e internetit informacionin e mëposhtëm:

2.1 Listën e shërbimeve të ofruara nga OST-ja, informacion për tarifat dhe kushtet e tjera për sigurimin e këtyre shërbimeve, duke përfshirë kushtet teknike për aksesin dhe lidhjen me sistemin e transmetimit;

2.2 Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të transmetimit dhe metodologjinë për përcaktimin e tarifës së lidhjes për lidhjen me sistemin e transmetimit;

2.3 Informacione në lidhje me kapacitet e sistemit të transmetimit dhe transaksionet në lidhje me to, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

2.4 Të dhëna për vëllimet e planifikuara dhe ato aktuale të energjisë elektrike që do të transmetohet nëpërmjet sistemit të transmetimit; dhe

2.5 Informacione të tjera të specifikuara në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

3. OST-ja duhet të arkivojë informacionin të cilit i jemi referuar në paragrafin 42 për 5 (pesë) vjet nga data kur ai është vendosur dhe duhet ta rinxjerrë atë me kërkesën e autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

VI. ZBATIMI I PROGRAMIT

A. Karakteri detyrues i Programit

1. Dispozitat e këtij Programi janë të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit dhe në rastet referuar këtij Programi dhe kontratave të mbyllura nga OST-ja ose në aktet ligjore në fuqi, zbatimi i dispozitave të caktuara të këtij Programi është detyrues për përfaqësuesit e autorizuar të OST-së, për audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit, si dhe palët e tjera të treta.

2. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OST-së, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët duhet të konfirmojnë me shkrim që janë të informuar për Programin dhe që do ta

zbatojnë atë. Në rast ndryshimesh ose amendimesh të Programit, zyrtari i pajtueshmërisë duhet të njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur drejtuesit e OST-së, punonjësit, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët për përmbajtjen e këtyre ndryshimeve ose amendimeve dhe drejtuesit përkatës, punonjësit, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët duhet të konfirmojnë me shkrim që ata janë njoftuar në kohë për këto ndryshime dhe amendime të Programit.

3. Të gjithë drejtuesit e OST-së dhe punonjësit duhet të udhëzohen rregullisht për zbatimin e këtij (të paktën një herë në vit). Drejtuesit e rinj dhe punonjësit duhet të udhëzohen para se të fillojnë mandatin e tyre ose para se të punësohen. Udhëzimet duhet të jepen nga zyrtari i pajtueshmërisë.

4. Nëse drejtuesit ose punonjësit e OST-së vihen në dijeni për shkeljen e ndonjë dispozite të Programit drejtuesi ose punonjësi duhet të informojë menjëherë zyrtarin e pajtueshmërisë.

5. Shkelja e ndonjë dispozite të Programit mund të cilësohet si shkelje e detyrimeve nga drejtuesi, punonjësi, përfaqësuesi i autorizuar, audituesi ose këshilltari dhe mund t'i japë OST-së të drejtën për të zbatuar veprimet disiplinore sipas termave dhe kushteve të përcaktuar tek aktet ligjore në fuqi dhe kontratat respektive dhe/ose aktet e brendshme të kompanisë OST.

B. Monitorimi i zbatimit të Programit

1. Monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin siç duhet të Programit duhet të kryhet nga zyrtari i pajtueshmërisë i cili duhet t'i ushtrojë funksionet e tij në bazë dhe sipas kompetencave të përcaktuara në nenin 21 të direktivës 2009/72/EC, në këtë Program dhe në kontratën e lidhur ndërmjet OST-së dhe zyrtarit të pajtueshmërisë.

2. Në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin e ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017 "Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjie elektrike" dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 2009/72/EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë", si dhe në nenin 21, të direktivës 2009/72/EC, zyrtari i pajtueshmërisë është emëruar nga Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., me vendimin nr. 20, datë 30.5.2017, i cili ka marrë miratimin e ERE-s me vendimin nr. 147, datë 28.9.2017. Gjithashtu, kërkesat minimale për zyrtarin e pajtueshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse janë vendosur nga Këshilli Mbikëqyrës i OST-së dhe janë miratuar nga ERE.

3. Kontrata ndërmjet OST-së dhe zyrtarit të pajtueshmërisë, e cila ka marrë tashmë miratimin e ERE-s, përfshin kërkesat e përcaktuara në nenin 21 të direktivës 2009/72/KE dhe të këtij Programi. Për këtë qëllim, OST-ja i ka dhënë ERE-s të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për të arsyetuar përputhshmërinë me kërkesat përkatëse. Kjo kontratë nënshkruhet ndërmjet palëve pas miratimit nga ERE.

4. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të jetë i pavarur gjatë kryerjes së detyrës së tij. Për këtë qëllim:

4.1 Zyrtari i pajtueshmërisë nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore të kryejë ndonjë funksion tjetër apo të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e aksioneve të saj, ose me çdo kompani të lidhur në aktivitetin e energjisë elektrike, përveç transmetimit të energjisë elektrike;

4.2 Zyrtari i pajtueshmërisë nuk duhet të ketë kryer asnjë detyrë tjetër profesionale dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore të kryejë ndonjë funksion tjetër ose të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e aksioneve, për një periudhë prej të paktën 3 (tre) vjet para emërimit si zyrtar i pajtueshmërisë për kompaninë OST;

4.3 Pas mbarimit të marrëdhënieve kontraktuale me OST-në, zyrtari i pajtueshmërisë nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore të kryejë ndonjë funksion ose të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e aksioneve të saj, ose me ndonjë kompani të lidhur në aktivitetin e energjisë elektrike, përveç transmetimit të energjisë elektrike për një periudhë prej jo më pak se 4 (katër) vjet; dhe

4.4 Zyrtari i pajtueshmërisë nuk duhet të ketë interes ekonomik ose të marrë përfitime financiare, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore, nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë

pjesë e tyre, ose nga kompanitë që kanë lidhje me aktivitetin e energjisë elektrike, përveç transmetimit të energjisë elektrike.

5. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të ketë autoritet të mjaftueshëm, si dhe kushtet e duhura financiare dhe organizuese që të mundësojnë, midis të tjerash, propozimin e masave për të siguruar zbatimin e këtij Programi dhe të kërkojë bashkëpunim nga drejtuesit dhe punonjësit e OST-së kur verifikon dhe siguron pajtueshmërinë me këtë Program.

6. Pagesa e zyrtarit të pajtueshmërisë nuk do të bazohet te vlerësimet e performancës nga drejtuesi i OST-së. Politikat për këtë pagesë janë përgatitur në mënyrë të qartë në kontratën midis OST-së dhe zyrtarit të pajtueshmërisë.

7. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të ketë akses te të dhënat e nevojshme dhe në zyrat e OST-së dhe te gjithë informacioni që duhet për të kryer detyrat e tij. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të ketë akses në zyrat e OST-së pa njoftimin paraprak.

8. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e drejtuesve të OST-së dhe organeve korporative, përfshirë asamblenë e përgjithshme, organet mbikëqyrëse dhe drejtuese, të cilat janë të detyruara të informojnë zyrtarin e pajtueshmërisë për takimet e programuara dhe duhet të sigurojnë të gjithë informacionin dhe materialet e nevojshme për të marrë pjesë në takime. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të marrë pjesë në të gjitha takimet të cilat adresojnë çështjet në vijim:

8.1 Kushtet për aksesin në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, në veçanti në lidhje me çmimet dhe shërbimet për të pasur akses në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, si dhe në lidhje me alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve (flukseve), transparencën, balancimin dhe tregjet dytësore;

8.2 Projektet e ndërmarra për të menaxhuar sistemin e transmetimit dhe për të mirëmbajtur e për të zhvilluar rrjetin e transmetimit, përfshirë investimet në linjat ndërkufitare të interkoneksjonit dhe lidhjet; dhe

8.3 Blerjet ose shitjet e energjisë të nevojshme për funksionimin e sistemit të transmetimit, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe shërbimin e balancimit.

9. Përveç të drejtave të përcaktuara në paragrafin 56, zyrtari i pajtueshmërisë duhet të ketë të drejtën të marrë pjesë te të gjitha takimet e organeve korporative të OST-së, te takimet e drejtuesve ose punonjësve duke përfshirë edhe takimet funksionale. Drejtuesit përgjegjës dhe/ose punonjësit duhet të njoftojnë zyrtarin e pajtueshmërisë për takimet e programuara ose jo.

10. Për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e këtij Programi dhe përmbushjen e detyrave, zyrtari i pajtueshmërisë, veçanërisht duhet të jetë përgjegjës për:

10.1 Monitorimin e zbatimit të këtij Programi;

10.2 Përpunimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e këtij Programi dhe dërgimin e saj në ERE;

10.3 Raportimin në organet përgjegjëse korporative të OST-së dhe dhënien e rekomandimeve për këtë Program dhe zbatimin e tij;

10.4 Investigimin dhe raportimin tek organet përgjegjëse korporative të OST-së për çfarëdo shkelje të pretenduar në lidhje me zbatimin e këtij Programi, dhe paraqitjen e zgjidhjeve të propozuara për masat e nevojshme korrigjuese;

10.5 Investigimin e konfliktit ekzistues ose të mundshëm të interesit për drejtuesit dhe punonjësit e OST-së, ofrimi i konsultimeve për të parandaluar konfliktet e mundshme të interesit dhe korrigjimin e konfliktit ekzistues të interesit, si dhe zgjidhjet që propozohen për masat e nevojshme korrigjuese;

10.6 Njoftimin e ERE-s për shkeljet në lidhje me zbatimin e këtij Programi;

10.7 Raportimin në ERE për marrëdhëniet tregtare dhe/ose financiare midis OST-së dhe kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre;

10.8 Paraqitja e propozimeve për organet përgjegjëse të OST-së, sipas miratimit paraprak nga ERE në lidhje me planin 10-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit ose investimeve individuale në rrjetin e transmetimit;

10.9 Monitorimi i pajtueshmërisë së OST-së me dispozitat e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe këtij Programi duke rregulluar konfidencialitetin në aktivitetet e kompanisë OST;

10.10 Monitorimi i ndryshimeve legjislative dhe rregullatore në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e këtij Programi;

10.11 Ofrimi i konsultimeve në lidhje me hartimin dhe miratimin e akteve të brendshme të kompanisë OST dhe pasqyrimi i ndryshimeve ligjore dhe rregullatore në këto akte;

10.12 Përgjigjja e pyetjeve të drejtuesve dhe punonjësve të OST-së, në lidhje me këtë Program;

10.13 Udhëzimin e drejtuesve dhe punonjësve të OST-së për këtë Program, zbatimin e tij dhe kur është e përshtatshme ndryshimet e tij të përcaktuara në paragrafin 56;

10.14 Koordinim i komunikimit me ERE-n, autoritetet e tjera kompetente, pjesëmarrësit dhe ose palët e treta që kanë lidhje me zbatimin e këtij Programi.

11. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, zyrtari i pajtueshmërisë duhet të japë opinion në lidhje me ndonjë dokument të brendshëm ose veprim të OST-së në lidhje me përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore në fuqi, duke përfshirë ndryshimet ligjore dhe rregullatore në fjalë dhe me këtë Program.

12. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të refuzojë udhëzimet ose kërkesën e OST-së, organeve korporative, të drejtuesve, punonjësve dhe ose ndonjë përfaqësuesi, të cilat janë ose ka mundësi të jenë në konflikt me mandatin dhe/ose pavarësinë e zyrtarit të pajtueshmërisë.

13. Zyrtari i pajtueshmërisë mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës i OST-së, pas miratimit paraprak nga ERE, për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapaciteteve profesionale.

C. Raportimi për zbatimin e Programit

1. Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], zyrtari i pajtueshmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST-së me këtë Program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-s. Raporti i parë do të dorëzohet brenda datës 31 mars 2019.

2. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të dorëzojë Raportin e referuar në paragrafin 62, edhe në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë.

3. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet të raportojë rregullisht, me gojë ose me shkrim, tek organet përkatëse korporative të OST-së në lidhje me zbatimin e këtij Programi.

VII. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky Program duhet të miratohet me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të OST-së dhe brenda 5 (pesë) ditëve duhet të dorëzohet në ERE për miratim. Ky Program hyn në fuqi ditën tjetër pas miratimit nga ERE.

2. Çdo ndryshim i këtij Programi duhet të pranohet dhe të hyjë në fuqi siç specifikohet në paragrafin 65.

ZYRTARI I PAJTUESHMËRISË
Brunilda Veizi

VENDIM
Nr. 104, datë 30.4.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E "METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT"

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa "b"; 20, germa "a"; 86, pika 6 dhe 87, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave në lidhje me rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, në zbatim të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, miratoi "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit".

- Kjo metodologji u hartua në kushtet kur:

- Nuk kishte një ndarje të llogarive midis aktivitetit të furnizimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim përcaktimin e saktë të shpenzimeve operative për aktivitetin e furnizimin të energjisë elektrike, një pjesë e të cilave duhet t'u alokohen klientëve të FMF-së.

- Nuk ekzistonte brenda OSHEE sh.a. një strukturë e posaçme e cila do të evidentonte kostot e administrimit dhe kostot e disbalancave të cilat

shkaktohen nga klientët që janë në kushtet e furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Ky furnizues nuk kishte filluar akoma të operonte dhe që pritej të furnizonte klientët për jo më shumë se 60 ditë.

- Ndarja e OSHEE sh.a. dhe krijimi i tri shoqërive të reja aksionare: Furnizimi i Shërbimit Universal sh.a., Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. do të krijojë kushtet për përcaktimin më të qartë të detyrave edhe ndarjen e kostove për çdo shoqëri, duke mundësuar përcaktimin e qartë të shpenzimeve operative/administrative për çdo kwh të furnizuar nga FSHU-ja që më tej çon në përcaktimin e qartë të kostove për FMF.

- Neni 3, i ligjit nr. 7/2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", amendoi nenin 86, të ligjit nr. 43/2015, duke përcaktuar se: Klienti fundor që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që në kuptim të nenit 109, të këtij ligji, del për herë të parë në treg të liberalizuar, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit. Në përfundim të kësaj periudhe, operatori i sistemit ndërpret furnizimin me energji elektrike të këtij klienti.

- Zgjatja e afatit të shërbimit për klientët e FMF-së nga 60 ditë në 2 vjet krijon mundësinë për furnizuesin e FMF-së të parashikimit dhe planifikimit të sasisë së energjisë së blerë për një periudhë afatgjatë dhe me çmime të favorshme. Për këtë arsye, mund të shikohet mundësia e përcaktimit të çmimeve afatgjata (vjetore) me të drejtë axhustmi të të ardhurave në periudhën pasardhëse.

- Së fundmi, në zbatim të nenit 109 dhe nenit 86 të amenduar të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", me qëllim nxitjen e hapjes së tregut, çdo çmim i aplikuar nga FMF-ja te klientët e shërbyer prej tij, më i ulët se çmimi i përcaktuar në vendimin e bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, nuk do t'i shërbente këtij qëllimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rishikimin e nenit 8 të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të bordit të ERE-s, si vijon:

Ishte:

Neni 8

Llogaritja e çmimit të furnizuesit të mundësisë së fundit. Llogaritja e çmimit të furnizuesit të mundësisë së fundit, do të bëhet sipas formulës së mëposhtme:

ÇFMFt = KDFPt + CBEt + TRrTSHt)

Ose:

ÇFMFt = CBEt +10% CBEt+ TRrTSHt)

Ku:

CFMFt - Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t

KDFPt - Kostoja direkte e furnizimit me pakicë sipas pikës 6 të nenit 6

Ku:

KDFPt - është 10% *CBEt

CBEt Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit

TRrTSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t.

Bëhet:

Neni 8

1. Llogaritja e çmimit të furnizuesit të mundësisë së fundit. Llogaritja e çmimit të furnizuesit të mundësisë së fundit do të bëhet sipas formulës së mëposhtme:

ÇFMFt = KDFPt + CBEt + TRrTSHt)

Ose: ÇFMFt = CBEt +10% CBEt+ TRrTSHt)

ÇFMFt = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA)

Ku:

CFMFt - Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t

KDFPt - Kostoja direkte e furnizimit me pakicë sipas pikës 6 të nenit 6

Ku:

KDFPt - është 10% *CBEt

CBEt Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit (tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE))

TRrTSHt - Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t

Pr - Kthim për riskun i përcaktuar për vitin

CA - Kosto administrative e Furnizuesit të Mundësisë se Fundit përcaktuar sipas nenit 6 të kësaj metodologjie.

Pas pikës 8.1 shtohet pika 2 me përmbajtje si më poshtë:

2. Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë te klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas vendimit të bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 105, datë 30.4.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "MALËSIA SOLAR 1" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK "LAHË E POSHTME", SHKREL, KOPLIK, RRETHI MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2.5 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; nenit 5, pika 1, germa "a"; nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë "Malësia Solar 1" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme" Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 236 prot., datë 7.3.2018, shoqëria "Malësia Solar 1" sh.p.k., paraqiti në ERE kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, për një afat 25-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 61, datë 26.3.2018, u shpreh për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Malësia Solar 1" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw, për një afat 25-vjeçar.

- Në vijim të vendimit të sipërcituar, ERE, me shkresën nr. 55/16 prot., datë 27.3.2018, publikoi në median e shkruar, njoftimin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Malësia Solar 1" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik dhe mbas përfundimit të afatit 20 ditë të paraqitjes se objeksioneve ose të ankesave, lidhur për sa publikuar, nuk rezulton të jetë paraqitur në ERE, ankesë ose objeksion nga subjekte ose persona fizikë.

- Aplikimi i shoqërisë "Malësia Solar 1" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat "a", "b", "c" dhe "d", 4.1.4, germat "a", "b", "c", "d", "e", 4.1.5, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Malësia Solar 1" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër me fuqi të instaluar 2.5 mw, për një afat 25-vjeçar (njëzetepesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 106, datë 30.4.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "MALËSIA SOLAR 2" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK "LAHË E POSHTME", SHKREL, KOPLIK, RRETHI MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR ME KAPACITET TË INSTALUAR 2.5 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; nenit 5, pika 1, germa "a"; nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë "Malësia Solar 2" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme" Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 1047/1, datë 6.3.2018, protokolluar me tonën me nr. 237 prot., datë 6.3.2018, shoqëria "Malësia Solar 2" sh.p.k. ka paraqitur në ERE kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, për një afat 25-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 62, datë 26.3.2018, u shpreh për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Malësia Solar 2 sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw, për një afat 25-vjeçar.

- Në vijim të vendimit të sipërcituar, ERE, me shkresën nr. 55/15 prot., datë 27.3.2018, publikoi në median e shkruar, njoftimin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Malësia Solar 2" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik dhe mbas përfundimit të afatit 20 ditë të paraqitjes se objeksioneve ose ankesave, lidhur për sa publikuar, nuk rezulton të jetë paraqitur në ERE, ankesë ose objeksion nga subjekte ose persona fizikë.

- Aplikimi i shoqërisë "Malësia Solar 2" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat "a", "b", "c" dhe "d", 4.1.4, germat "a", "b", "c", "d", "e", 4.1.5, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Malësia Solar 2" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me fuqi të instaluar 2.5 mw, për një afat 25-vjeçar (njëzetepesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 107, datë 30.4.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "MALËSIA SOLAR 3" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK "LAHË E POSHTME", SHKREL, KOPLIK, RRETHI MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR ME KAPACITET TË INSTALUAR 2.5 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "a"; nenit 5, pika 1, germa "a"; nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë "Malësia Solar 3" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme" Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 1048/1, datë 6.3.2018, protokolluar në ERE me nr. 238 prot., datë 6.3.2018, shoqëria "Malësia Solar 3" sh.p.k., paraqiti kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, për një afat 25-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 26.3.2018, u shpreh për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Malësia Solar 3" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw, për një afat 25-vjeçar.

- Në vijim të vendimit të sipërcituar, ERE, me shkresën nr. 55/17 prot., datë 27.3.2018, publikoi në median e shkruar, njoftimin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Malësia Solar 3" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik dhe mbas përfundimit të afatit 20 ditë të paraqitjes se objeksioneve ose ankesave, lidhur për sa publikuar, nuk rezulton të jetë paraqitur në ERE, ankesë ose objeksion nga subjekte ose persona fizikë.

Aplikimi i shoqërisë "Malësia Solar 3" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat "a", "b", "c" dhe "d", 4.1.4 germat "a", "b", "c", "d", "e", 4.1.5, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Malësia Solar 3" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Lahë e Poshtme", Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër me fuqi të instaluar 2.5 mw, për një afat 25-vjeçar (njëzetepesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 7448/5, datë 10.5.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Zgjerim i hapësirës së varrezave në fshatin Shenepremte", Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë.

Subjekti kërkues është Bashkia Divjakë. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 109 200 (njëqind e nëntë mijë e dyqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "ZGJERIM I HAPËSIRËS SË VARREZAVE NË FSHATIN SHENEPREMTE", NJËSIA ADMINISTRATIVE TËRBUF, BASHKIA DIVJAKË

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja tokë arë/m²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Faslli Kasmi	473/1	3341	300	109,200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI				**109,200**	

KËRKESË
Nr. 7226, datë 9.5.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i rrjetit rrugor, Bashkia Shijak", loti 1.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Shijak.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 138, ditë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për llogaritjen e vlerës së pasurive të llojit "truall", "objekt banimi" dhe "objekt shërbimi", për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 10,102,935 (dhjetë milionë e njëqind e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "REHABILITIMI I RRJETIT RRUGOR, BASHKIA SHIJAK", LOTI 1

Çmimi për pasurinë objekt banimi sipas shkresës së ZVRPP
Vlera për pasurinë objekt shërbimi me situacion sipas çmimeve nga EKB.
Çmimi për pasurinë truall sipas Vendimit nr. 89, datë 03.02.2016.

INVESTITORI BASHKIA SHIJAK

Nr.	Emer Mbiemer	Zona Kadastrale	N/pasurisë	Sipërfaqja e Përgjithshme Truall në m²	Sipërfaqja e prekur Truall në m²	Çmimi për truall	Objekti sip.e përgj. në m²	Objekti sip.e përgj. që preket në m²	Çmimi për objekt banimi	Vlera e përllogaritur objekt shërbimi	Vlera (Truall i prekur nga shponësimi) Lekë	Vlera (Objekt i prekur nga shponësimi) Lekë	Vlera (Truall + Objekt i prekur nga shponësimi) Lekë	Konfirmimi nga ZVRPP, Durrës
1	B.P. Nezaqet Deliallisi, Shefqet Deliallisi, Ymer Deliallisi, Zana Deliallisi	3369	4/28	276	175.7	3047	200.6	200.6	41, 000		535,358	8,224,600	8,759,958	Konfirmuar nga ZVRPP, me shkresë nr.8378/1, datë 21.07.2017
2	Skender Zalla	3369	12/12	59.2	59.2	3,047.00	51	51		1,162,595	180,382	1,162,595	1,342,977	Konfirmuar nga ZVRPP, me shkresë nr.282, datë 24.07.2017
Shuma totale													10,102,935	

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 534 (2171), datë 17.4.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Jovan Doce, i datëlindjes 23.2.1970.

KËRKESË

Shtetasi Bujar Gosa, i datëlindjes 10.3.1963, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilir Gosa, i datëlindjes 25.6.1971, zhdukur në datën 20.3.1994.

KËRKUES
Bujar Gosa

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 19, datë 19.1.2018, të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, "Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike, për vitin 2018", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 10, datë 31 janar 2018, korrigjohet gabimi material në përmbajtjen e tij, si më poshtë:

Zëvendësohet togfjalëshi "**nenit 10**, të ligjit nr. 7/2017" me "**nenit 22**, të ligjit nr. 7/2017".

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë